Bashkia Përmet

PLANI I KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA PËRMET

2019 - 2023

Bashkia Përmet

PLANI
I
KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA PËRMET

2019 - 2023

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 46, datë 27/05/2019

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Ndihmë për Fëmijët
FONDACIONI "Ndihmë për Fëmijët" (NPF) - "Help for Children" FOUNDATION (NPF)

UNITED NATIONS
ALBANIA

UNDP

BY 2030

Plani i Kujdesit Social është hartuar nga Bashkia Përmet në konsultim me përfaqësues të institucioneve vendore dhe shoqërisë civile, me mbështetjen teknike të Fondacionit "Ndihmë për Fëmijët" në kuadër të Programit të përbashkët të Kombeve te Bashkuara "Askush Të Mos Mbetet Pas" që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikëqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP.

Leave
No One
Behind

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE 5

1. METODOLOGJIA 7
   - 1.1 Qëllimi dhe objektivat 7
   - 1.2 Parimet e planit të kujdesit social 7
   - 1.3 Vlerat 8
   - 1.4 Çfarë përmban PKS i Bashkisë Përmet 8
   - 1.5 Procesi dhe fazat në të cilat ka kaluar hartimi i PKS 9

2. NJË PREZANTIM I BASHKISË PËRMET 10
   - 2.1 Popullsia dhe treguesit demografik 11
   - 2.2 Arsimi 13
   - 2.3 Shëndetësia 13
   - 2.4 Ekonomia 13
   - 2.5 Punësimi dhe papunësia 14

3. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, PROFESIONALE DHE FINANCIARE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL 15
   - 3.1 Mbrojtja dhe shërbimet social 15
     - *3.1.1 Struktura e shërbimit social 15*
     - *3.1.2 Zyra për barazinë gjinore dhe dhunën në familje 16*
     - *3.1.3 Njësia e mbrojtjes së fëmijëve 16*
   - 3.2 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale 17
   - 3.3 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale 17
   - 3.4 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesit social 18
   - 3.5 Vlerësimi i situatës sociale për një vendimarje të informuar 18
   - 3.6 Kufizimet, mungesat dhe çështje për adresim 18

4. NEVOJAT PËR SHËRBIME SOCIALE TË GRUPEVE VULNERABËL DHE ATYRE NË RREZIK 20
   - 4.1 Famijet e varfëra 20
   - 4.2 Personat me aftësi të kufizuar 21
   - 4.3 Fëmijët në rrezik 21
     - *4.3.1 Fëmijët me aftësi ndryshe 22*
     - *4.3.2 Fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë 23*
   - 4.4 Gratë me probleme sociale dhe dhuna në familje 24
   - 4.5 Komunitetet 24
   - 4.6 Të rinjte në rrezik 25
     - *4.6.1 Të rinjtë në konflikt me ligjin 25*

5. ANALIZA SWOT DHE PËRCAKTIMI I ÇËSHTJEVE KRITIKE DHE PRIORITETEVE 26
5.1 Çështjet kritike 27

6. PERCAKTIMI I PRIORITETEVE (FUSHAVE, QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË PKS-SË) 28

ANEKSET
Aneksi 1. Plani i veprimit për shërbimet e kujdesit social të Bashkisë Përmet 32
Aneksi 2. Plani i monitorimit dhe vlerësimit 40
Mënyra e raportimit dhe konsultimit *40*
Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit *41*
Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit *41*
Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit *42*
Aneksi 3. Kostimi dhe hendeku buxhetor 43
Shënime të përgjithshme *43*
Përmbledhje e kostos së Planit të Veprimit *45*
Rezultatet kryesore dhe konkluzionet nga procesi i kostimit *46*
Rekomandime per buxhetimin e PKS Bashkisë Përmet *46*
Aneksi 4. Shporta e Shërbimeve 47

HYRJE

Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një reformë në sistemin e shërbimeve sociale e cila synon forcimin dhe fuqizimin e të gjitha niveleve të qeverisjes për të planifikuar, buxhetuar dhe monitoruar shërbime shoqërore të integruara që i përgjigjen nevojave reale të grupeve në nevojë. Një nga objektivat themelore të reformës është decentralizimi i shërbimeve për të qenë sa më afër komunitetit dhe përgatitja e qeverisjes vendore e shoqëruar me fuqizimin e strukturave dhe mekanizmave për të planifikuar, ofruar dhe monitoruar shërbimet sociale në territor. Nga ana tjetër Reforma Administrativo-Territoriale dhe strategjia e decentralizimit, ka riformatuar funksionet qeverisëse në nivel vendor[1] për t'ju përgjigjur edhe reformës së shërbimeve sociale.

Në këtë kuadër Bashkia Përmet ka ndërmarrë hartimin e Planit te Kujdesit Social 2019-2023, i cili synon forcimin e strukturave të bashkisë, duke rritur burimet dhe kapacitetet njerëzore dhe financiare, për të ofruar shërbime cilësore. Gjithashtu Plani do të institucionalizojë dhe standardizojë menaxhimin e shërbimeve sociale për të vlerësuar dhe adresuar me shërbime individët, familjet apo komunitetet më në nevojë.

Në vetvete PKS i Bashkisë Përmet konvergon me qëllimet strategjike të reformës e cila ka në fokusin e saj:

1. Një qasje të re dhe të qartë lidhur me sistemin e shërbimeve sociale në Shqipëri, ku rrolin kryesor e merr pushteti vendor;
2. Rritjen e kapaciteteve të Njësive të Qeverisjes Vendore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve sociale duke mundësuar që ata të kenë më tepër përgjegjësi për të ofruar shërbime në komunitetin e tyre;
3. Sigurimin e burimeve materiale dhe financiare të mjaftueshme për të përballuar nevojat sociale të popullatës, me qëllim sigurimin e jetesës dinjitoze pavarësisht problemeve sociale të përkohshme apo të përhershme që përjetojnë individët, familjet apo grupe të caktuara

Plani i Kujdesit Social i Bashkisë Përmet bën një fotografim të situatës sociale dhe ekonomike të komunitetit që jeton në territorin e kësaj bashkie dhe një analizë të nevojave të grupeve të veçanta të këtij komuniteti për shërbime të kujdesit social. Në pjesën e dytë, dokumenti përmban qëllimet, objektivat dhe masat të artikuluara nga aktorët e përfshirë në procesin e hartimit të planit, të cilat priten të ndikojnë në përmirësimin e jetës së grupeve të përjashtuara të popullatës, si dhe nevojën për burime materiale, financiare e njerëzores për realizimin e këtyre masave, për periudhën 2019-2023.

Plani është në koherencë me: Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social 2015-20, Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (2015–2020), Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", "Dokumentin e politikave të decentralizimit të ndihmës dhe shërbimeve sociale" dhe Ligjin nr. 121/ 2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë". Ky bashkëpunim ka konsistuar në vlerësimin e nevojave lidhur me hartimin e planit, buxhetimin e tij dhe identifikimin e burimeve financiare për ta zbatuar, duke rritur paralelisht edhe kapacitetet vendore në planifikim.

1 Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 24

1. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË PLANIT TË KUJDESIT SOCIAL PËR BASHKINË PËRMET

Metodologjia e ndjekur për hartimin e PKS lejon planifikimin e shërbimeve sociale në nivel komunitar në mënyrë të tillë që të përmbushen nevojat specifike për shërbime sociale të individit, familjeve dhe komunitetit. Metodologjia e ndjekur angazhon të gjithë aktorët e sistemit të shërbimeve sociale (përdoruesit, ofruesit dhe mbështetësit), si në procesin e hartimit të PKS-së ashtu dhe gjatë zbatimit të tij.

1.1 Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i këtij dokumenti është të krijojë një kornizë e cila do të lehtësojë zbatimin e synimeve që do t›u mundësojnë banorëve të Bashkisë Përmet të arrijnë një kohezion social dhe një nivel të pranueshëm të mirëqenies; një dokument i cili mbështet përfshirjen sociale dhe parandalon përjashtimin social të individëve, familjeve dhe grupeve të veçanta.

Objektivat

1. Të përmbushë një nga përgjegjësitë ligjore të qeverisjes vendore lidhur me sigurimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë;
2. Të mobilizojë të gjitha burimet ekzistuese (njerëzore, materiale dhe financiare) dhe të mundësojë përdorimin me efikasitet të tyre (paratë shpenzohen vetëm në ato shërbime që janë vërtetë të nevojshme);
3. Të rrisë aksesin dhe cilësinë e shërbimeve për individët në nevojë, familjet e komunitetet me nevoja të veçanta;
4. Të promovojë qasje novatore në fushën e shërbimeve të kujdesit social për të siguruar praktika të punës që parandalojnë përjashtimin social të grupeve të veçanta.

1.2 Parimet e Planit të Kujdesit Social

Parimet e ndjekura për hartimin PKS janë ato të demokracisë përfaqësuese. Ajo çfarë e ka udhëhequr procesin është:

- Gjithëpërfshirja. Përfshirje e të gjithë aktorëve në fushën e shërbimeve të kujdesit social. Nxit dialogun dhe bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve, rrit ndjenjën e të qenit anëtar i një komuniteti dhe mundëson identifikimin e burimeve të reja njerëzore dhe materiale;
- Maksimizimi dhe efikasiteti i përdorimit të burimeve. Në kushtet e burimeve të kufizuara, është bërë dialog me palët dhe negociata me grupet e interesit për vendosjen e prioriteteve;
- Në qendër janë rezultatet. Arritjen e rezultateve që janë kërkuar dhe mbështetur nga shumica e palëve që kanë marrë pjesë në proces;
- Të drejtat e njeriut, barazia dhe mosdiskriminimi.

1.3 Vlerat

Vlerat e mëposhtme reflektojnë besimin e komunitetit për rolin dhe përgjegjësitë e Pushtetit Vendor lidhur me përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve sociale në komunitet.

- **Bashkëpunues**. Ne punojmë së bashku me grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile, ofruesit e shërbimeve dhe partnerë të tjerë në komunitet;
- **Shërbime të orientuara drejt nevojave**. Ne dëgjojmë dhe mundohemi t'i përgjigjemi përfitueseve me shërbime sipas nevojave specifike që ata kanë;
- **Të hapur me publikun**. Ne vendosim në qendër objektivat, matim performancën tonë dhe raportojmë para publikut suksesin ose mos-suksesin në arritjen këtyre objektivave;
- **Të besueshëm**. Ne jemi të përgjegjshëm para publikut gjatë ushtrimit të funksioneve, rroleve dhe aksioneve si individë dhe si qeverisje;
- **Mbështesim risitë.** Ne jemi krijues, mësojmë nga eksperiencat dhe rezultatet e arritura, dhe shikojmë përpara për të gjetur rruge efikase për të zgjidhur problemet dhe për t'i shërbyer publikut.

1.4 Çfarë përmban PKS i Bashkisë Përmet

1. Një përshkrim i Bashkisë Përmet, bazuar në të dhëna statistikore dhe administrative për situatën demografike (strukturën e popullsisë, lindjet dhe vdekjet, fenomenet migratore etj.), situatën ekonomike (sipërmarrjen, punësimin dhe papunësinë), situatën shëndetësore dhe arsimore;
2. Plani përmban një përshkrim dhe një analizë të burimeve ekzistuese të shërbimeve të kujdesit social (institucionet dhe strukturat publike në nivel vendor, ofruesit jo-publik të shërbimeve sociale dhe burimet njerëzore dhe kapacitetet e tyre profesionale). Gjithashtu Plani përmban edhe burimet financiare të Bashkisë Përmet. Fondi i dedikuar për shërbime sociale në tre vitet e fundit;
3. Një përshkrim dhe një analizë të nevojave për shërbime që kanë grupet në rrezik;
4. Një vizion i Bashkisë për ofrimin e shërbimeve sociale; Identifikimi i prioriteteve dhe objektivave të zhvillimit të shërbimeve te kujdesit social;
5. Afatet kohore për progresin e zhvillimit dhe zbatimit të planit. Gjithashtu mënyrën në të cilën aktorët në nivel lokal do të angazhohen në zhvillimin dhe zbatimin e PKS - përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrimet e palëve;
6. Një metodologji e monitorimit, vlerësimit dhe ndoshta modifikimit të PKS.

1.5 Procesi dhe fazat në të cilat ka kaluar hartimi i PKS

Faza e parë: Fillimi i procesit

- Ngritja e grupit të punës;
- Përcaktimi i palëve që janë të interesuar të marrin pjesë në procesin e hartimit te PKS-së;
- Marrja e mbështetjes nga Bashkia Përmet.

Faza e dytë: Identifikimi i problemeve dhe çështjeve kritike:

- Mbledhja e të dhënave, analiza dhe vlerësimi i burimeve ekzistuese;
- Konsultime me strukturat kryesore të ofrimit të shërbimeve sociale, konsultime me strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vendor, konsultimet me drejtuesit e projektit dhe koordinatorët, intervistë me përfaqësues të Këshillit Bashkiak, intervista me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile[2] që operojnë në Përmet;
- Vlerësimi dhe analiza SWOT.

Faza e tretë: Propozime për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social

- Drejtimet në të cilat do të zhvillohen shërbimet e kujdesit social;
- Synimet që do të adresojnë prioritetet e vendosura;
- Burimet që do të përdoren për të realizuar masat.

Faza e katërt: Hartimi i Plani të Kujdesit Social për Bashkinë Përmet

- Hartimi i planit të veprimit me qëllimet, rezultatet e pritshme, masat/aktivitetet, institucionet bartëse dhe treguesit e matjes së realizimit të aktiviteteve;
- Kostimi i aktiviteteve dhe identifikimi i hendekut të buxhetit (Buxheti i nevojshëm kundrejt buxhetit që sigurohet nga burime të vetat të pushtetit vendor të parashikuara për 4 vitet e ardhshme);
- Validimi i dokumentit me Sektorin e Shërbimeve Sociale dhe palët e interesuara në Bashkinë Përmet;
- Aprovimi i PKS-së nga KB.

Faza e pestë: Nga planifikimi tek zbatimi i PKS-së

- Zbatimi i planit;
- Informimi i publikut mbi zbatimin e planit;
- Angazhimi i partnerëve të rinj për zbatimin e PKS-së;
- Prezantimi i instrumenteve për të reflektuar ndryshimet në PKS.

2 "Solidariteti Tani", "FLOEM", " Arminda Ago"

2. NJË PREZANTIM I BASHKISË PËRMET

Bashkia Përmet bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës dhe shtrihet në pjesën juglindore të vendit. Ajo kufizohet në veri me Skrapar, në lindje me Bashkinë Kolonjë, në perëndim me Bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë dhe në jug me Konicën, Greqi. Qendra e Bashkisë është qyteti i Përmetit, i cili përfaqëson qendrën e zhvillimit ekonomik dhe social jo vetëm për Bashkinë e Përmetit por të gjithë komunitetit gjeografik që njihet si Lugina e Vjosës.

Bashkia e Përmetit përbëhet nga 5 (pesë) njësi administrative të cilat janë: Përmet, Çarshovë, Frashër, Petran dhe Qendër Piskovë. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Të gjitha njësitë e bashkisë janë njësi malore duke qenë se terreni është i pjerrët në më shumë se 45% të sipërfaqes së tij.

Tabela 1 - Përbërja administrative e territoriale e bashkisë Përmet

Bashkia	Njësitë administrative	Qytetet dhe fshatrat respektive
Përmet	Përmet	Qyteti Përmet
	Çarshovë	Fshatrat; Çarshovë, Vllaho , Psillotere, Biovizhde, Zhepë, Draçovë, Iliar , Munushtir, Strëmbec, Pëllumbar, Kanikol
	Frashër	Fshatrat; Frashër, Zavalan, Ogren , Kostrec, Gostivisht, Miçan, Verçisht, Kreshovë, Soropull
	Petran	Fshatrat; Petran, Leshnicë, Leus, Lipe, Qilarishtë, Badilonjë, Bënje , Novosele, Delvinë, Kaludh, Lupckë, Gjinakar, Ogdunan, Lipivan-Trabozishtë, Tremisht, Bodar
	Qendër Piskovë	Fshatrat; Piskove, Bual, Kosine, Rapcke, Mokricë-Zleushë, Kutal, Kosovë, Hotovë, Odriçan, Raban, Alipostivan, Borockë, Gosnisht, Pagri, Pacomit, Grabovë, Argovë

Territori i Bashkisë është i organizuar përgjatë luginës së lumit Vjosa. Njësitë e Çarshovës, Petranit, Përmetit dhe një pjesë e Qendër Piskovë shtrihen përgjatë luginës, ndërsa, njësia administrative e Frashërit përbën skajin më të largët të bashkisë dhe është tërësisht një zonë malore. Jetesa përgjatë luginës përcakton edhe një standard më të mirë jetese për komunitetet lokale krahasuar me ato që jetojnë më larg luginës.

2.1 Popullsia dhe treguesit demografik

Përmeti bën pjesë në rajonin statistikor (NUTS 3– Qarku Gjirokastër).

Tabela 2 - Të dhëna mbi sipërfaqen, ndarjen administrative dhe numrin e popullsisë

Sipërfaqe (km2)	Numri i Njësive Administrative	Numri i Qyteteve	Numri i Fshatrave	Numri i Familjeve	Popullsia sipas Regjistrit Civil 2016	Popullsia sipas Census 2011
601.95	5	1	51	6,868	19,872	10,614

Burimi: Bashkia Përmet

Siç u përmend më lart, një pjesë e rëndësishme e territorit të bashkisë shtrihet në terren malor. Një reliev i tillë kushtëzon dendësinë relativisht të ulët të popullsisë për zonat më të largëta.

Popullsia e Bashkisë sipas Regjistrit Civil 2017 raportohet 19.872 banorë. Më shumë se gjysma e popullsisë, rreth 56%, jeton në qytetin e Përmetit. Njësia administrative me numrin më të vogël të popullsisë, vetëm 4% e totalit të popullsisë së bashkisë, është Frashëri. Njësitë e tjera (Çarshovë, Petran dhe Qendër Piskovë) përbëjnë 40% të popullsisë së bashkisë. Bashkia e Përmetit ka fshatra që kanë një numër shumë të ulët banorësh, siç është fshati Frashër i cili ka vetëm 48 banorë[3] (fshati me popullsinë më të ulët në vend). Kjo analizë demografike na shërben për të orientuar disa shërbime të kujdesit social të cilat diktohen nga situata të veçanta demografike siç janë shërbimet sociale dhe shëndetësore për të moshuarit e vetmuar në zona shumë larg qytetit ose malore.

Tabela 3 - Të dhëna për numrin e popullsisë sipas njësive administrative

Njësitë administrative	Censusi 2011			Regjistri civil 2017		
	Femra	Meshkuj	Total	Femra	Meshkuj	Total
Përmet	2.984	2.961	5945	5.028	4.832	9.860
Çarshovë	463	455	918	1.425	1.544	2.969
Petran	791	831	1622	1.550	1.540	3.090
Qendër Piskovë	845	897	1742	1.602	1.668	3.270
Frashër	177	210	387	314	369	683
Total	**5.260**	**4.904**	**10.614**	**9.919**	**9.953**	**19.872**

Burimi: Bashkia Përmet

Në tabelën e më sipërme, shihet se raporti gjinor i popullsisë në Bashkinë Përmet është i balancuar. Gratë përfaqësojnë 50% të popullsisë totale. Por në nivel të njësive administrative, përqindja e grave dhe vajzave varion nga 46% në 50%.

Popullsia e grup moshës 15-64 vjeç që përfaqëson popullsinë aktive, përbën 66% të popullsisë. Ajo që vihet re në piramidën e moshës për Bashkinë Përmet është se grup mosha 65+ vjeç, përfaqëson 18% të popullsisë, tregues ky që është më i lartë se mesatarja e vendit (11.3%). Nga ana tjetër grup mosha 0-14 vjeç përbën 16% të popullsisë së Bashkisë Përmet, tregues i ulët në krahasim me mesataren e vendit (20.7%).

3 Planin Operacional i Zhvillimit Vendor, Bashkia Përmet

Tabela 4 - Popullsia, raporti sipas grup moshave

Popullsia sipas grup moshave	Bashkia Përmet	Mesatarja e vendit
	%	%
0-14	16%	20.7%
15-64	66%	68%
65- e lart	18%	11.3%

Burimi: Bashkia Përmet

Dinamikat e popullsisë

I gjithë territori i Bashkisë është karakterizuar nga migrimi dhe emigrimi i popullatës në dy dekadat e fundit. Të dhënat e Census 2001 dhe 2011, tregojnë se popullsia e Bashkisë së Përmetit është zvogëluar me më shumë se gjysmën e popullsisë (56%). Njësia administrative Frashër në harkun kohor 2001-2011, ka patur një largim masiv të banorëve në masën 82%. Po kështu, edhe popullsia e njësisë administrative Çarshovë është ulur me 71%. Përmeti (qyteti) ka përqindjen më të vogël të popullsisë së larguar (51%), krahasuar me njësitë e tjera administrative.

Të dhënat tregojnë për një rënie të konsiderueshme të popullsisë për të gjitha njësitë administrative, e cila ka si shkak kryesor migrimin e brendshëm (largimin e banorëve drejt qytetit të Përmetit dhe qyteteve të tjera) dhe emigrimin (kryesisht në Greqi). Por ulja e popullsisë është shkaktuar edhe për shkaqe të tjera. Kështu, treguesit e lindshmërisë dhe vdekshmërisë të cilët përbëjnë variablat bazë për vlerësimin e shtesës natyrore të popullsisë tregojnë se ky tregues i shprehur si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve është negativ.

Duke krahasuar dy vitet e fundit shikojmë se në vitin 2018 në Bashkinë Përmet ka patur 17 lindje dhe 66 vdekje. Megjithëse numri i lindjeve është rritur me 17% krahasuar me një vit më parë dhe ai i vdekjeve me vetëm 5%, përsëri diferenca e madhe ndërmjet numrit të lindjeve dhe vdekjeve në bashki tregon për një trend negativ të shtesës natyrore të popullsisë.

Tabela 5 - Numri i lindjeve dhe vdekjeve për dy vitet e fundit në Bashkinë Përmet

	2017	2018
Lindje	14	17
Vdekje	62	66
Martesa	15	27
Divorce	5	7

Burimi: Bashkia Përmet Zyra e Gjendjes Civile

Shtesa natyrore negative, migrimi dhe emigrimi kryesisht i popullatës aktive, kanë qenë faktorë të rëndësishëm të cilët kanë përcaktuar edhe tendencën e plakjes së popullsisë me ritme të shpejta. Procesi i plakjes vihet re nga rritja e lehtë e popullsisë mbi 65 vjeç, shoqëruar kjo me uljen e numrit të popullsisë në moshë të re 0-14 vjeç. Plakja e popullsisë është shoqëruar me fenomenin social të « të moshuar të vetmuar », i cili po ndodh kryesisht në zonat e thella rurale të bashkisë.

2.2 Arsimi

Zona e Përmetit është një zonë e njohur për traditat e saj arsimdashëse. Vihet re një nivel i ulët i braktisjes së shkollës 9-vjeçare, si dhe interes i lartë për vazhdimin e shkollës së mesme dhe studimeve universitare nga ana e të rinjve. Kushtet e shkollave janë relativisht të mira me një numër mesatar prej 25 nxënësish në klasë. Për shkak të migrimit dhe emigrimit numri i shkollave 9-vjeçare ka rënë me 20%. Në total Përmeti numëron 12 shkolla të ciklit të ulët, 6 shkolla 9-vjeçare dhe 2 shkolla të mesme.

Tabela 6 - Të dhëna për arsimin 9-vjeçar dhe të mesëm

Shkollat nëntëvjeçare			Shkollat e mesme		
Numri i shkollave 9-vjeçare	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve	Numri i shkollave të mesme	Numri i nxënësve	Numri i mësuesve
6	859	93	2	395	31

Burimi: Bashkia Përmet

Arsimi parashkollor

Vetëm qyteti i Përmetit ka një çerdhe me ushqim. Ndërsa ka edhe 10 kopshte pa ushqim (3 në qytet dhe 7 në fshatra). Numri i fëmijëve për secilën strukturë varion nga 3 fëmijë për fshatrat Rapcke dhe Kutal në 85 fëmijë për Kopshtin nr.1 të qytetit të Përmetit.

Tabela 7 - Të dhëna për arsimin parashkollor

Cerdhet			Kopshtet		
Numri i çerdheve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve	Numri i kopshteve	Numri i fëmijëve	Numri i edukatoreve
1	21	4	10	244	20

Burimi: Bashkia Përmet

2.3 Shëndetësia

Një rëndësi të veçantë në shërbimin shëndetësor në Bashkinë Përmet ka shërbimi parësor. Ky shërbim ofrohet nëpërmjet qendrave shëndetësore, ambulancave dhe poliklinikave.

Në vitin 2018 në Bashkinë Përmet numërohen 8 qendra shëndetësore, një ambulancë, dhe një poliklinikë e specializuar. Shërbimi spitalor publik në Përmet ofrohet nga spitali rajonal i Gjirokastrës i cili ofron shërbimet bazë dhe të specializuara.

2.4 Ekonomia

Sektorët si bujqësia, blegtoria, agroindustria, turizmi, tregtia dhe shërbimet përbëjnë drejtimet ekonomike në të cilat është e përfshirë popullsia lokale. Për shkak të natyrës mikse të ekonomisë, banorët janë të punësuar në sektorë të ndryshëm si bujqësi, industri dhe shërbime. Sektori i shërbimeve punëson numrin më të madh të forcës aktive të punës, pas këtij renditet bujqësia. Edhe pse Bashkia ka profil bujqësor, sektori i shërbimeve përfaqëson numrin më të lartë të punësimit, bujqësia përfaqëson

sektorin kryesor ekonomik. Pjesa më e madhe e fermave janë të vogla dhe kryesisht familjare. Numri i ndërmarrjeve aktive në fund të vitit 2017 është 422, ndërsa numri i fermave gjithsej është 2962, prej të cilave vetëm 44 ferma janë të pajisura me numër identifikimi NIPT.

Tabela 8 - Profili ekonomik i Bashkisë Përmet

Numri i Bizneseve (Gjithsej)	Biznes i madh	Biznes i vogël	Numri i Fermave
422	69	353	2,962

Gjatë vitit 2017 janë regjistruar 73biznese të reja ndërsa gjatë vitit 2018, 81 biznese. Grupi i prodhuesve të shërbimeve vazhdon të jetë mbizotërues në ekonominë lokale të Bashkisë Përmet me rreth 95% të ndërmarrjeve aktive. Aktiviteti ekonomik "Tregtia me pakicë" përfaqëson 50% të ndërmarrjeve, ndërsa "akomodim dhe shërbim ushqimor" i lidhur ngushtë me industrinë e turizmit përfaqëson 30%.

Tabela 9 - Numri i bizneseve të reja të regjistruara sipas viteve në Bashkinë Përmet

Ndërmarrje sipas aktivitetit ekonomik	2017	2018
Totali	73	81
Ndërmarrje prodhuese		
Bujqësi		
Industri	4	4
Peshkim		
Ndërmarrje shërbimesh		
Tregti	37	38
Transport	15	14
Akomodim dhe shërbim ushqimor	17	25
Informacion e komunikim		
Të tjera		

Burimi: Bashkia Përmet (Sporteli i shërbimit të QKB-së në Bashki)

Ashtu siç tregohet edhe nga tabela e mësipërme, turizmi është një aktivitet ekonomik i rëndësishëm për bashkinë. Përmeti është vendi ideal për turizmin familjar dhe atë të aventurës. Megjithëse në hapat e para, zhvillimi i agroturizmit shihet si një oportunitet për punësimin e të rinjve ashtu edhe për rikthimin e familjeve që kanë emigruar nga zona.

2.5 Punësimi dhe papunësia

Statistikat e tregut të punës janë thelbësore për hartimin e Planit të Kujdesit Social. Shkalla e punësimit (raporti i të punësuarve kundrejt popullsisë në moshë pune), dhe ajo e papunësisë (raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës) janë tregues social kyç. Ky seksion i dokumentit siguron informacion mbi të dhënat e punësimit dhe papunësisë kryesisht nga Zyra e Punës Përmet, duke përfshirë edhe një analizë të bazuar në të dhëna të disagreguara sipas moshës. Kështu sipas Zyrës së Punësimit punëkërkues të papunë të moshës 15-39 vjeç të regjistruar, janë 309 persona nga rreth 530 persona të regjistruar gjithsej.

3. VLERËSIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE, PROFESIONALE DHE FINANCIARE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL

3.1 Mbrojtja dhe shërbimet sociale

3.1.1 Struktura e Shërbimit Social

Në Bashkinë Përmet funksionon "Zyra e Ndihmës dhe Shërbimit Social" me tetë punonjës, që drejtohet nga koordinatori i zyrës. Në katër njësitë administrative të Bashkisë ka nga një administrator shoqëror, ndërsa në qytetin e Përmetit janë dy punonjës, nga të cilët një administrator shoqëror për ndihmën ekonomike dhe një për skemën e pagesës së paaftësisë. Në strukturën e Bashkisë, zyra e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale është në varësi të Sektorit Ekonomik.

Tabela 10 - Numri i punonjësve të shërbimit social sipas njësive administrative dhe funksionit

Njësia Administrative	Numri i punonjësve
Përmet	1 koordinatori zyrës 1 specialist NE 1 specialist PAK 1 Dhuna ne familje dhe NJMF
Piskovë	1 për NE dhe PAK
Frashër	1 për NE dhe PAK
Petran	1 për NE dhe PAK
Çarshovë	1 për NE dhe PAK
Totali	**8 Punonjës**

Burimi i informacionit: Bashkia Përmet

Misioni i Zyrës së Ndihmës dhe Shërbimit Social është evidentimi i grupeve në nevojë brenda territorit të Bashkisë Përmet dhe ofrimi i ndihmës së nevojshme ekonomike dhe shërbimit të duhur të kujdesit social. Detyrat specifike të Zyrës së Ndihmës dhe Shërbimit Social janë përcaktuar nga Ligji 44/2016, Neni 30 "detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës përkatëse" dhe neni 31 "detyrat e administratorit shoqëror".

Të qenit "zyrë" dhe jo "sektor" apo "drejtori" shpesh herë krijon vështirësi në administrimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme sociale. Gjithashtu ofrimi i shërbimeve vështirësohet edhe nga mungesa e stafit të specializuar. Veçanërisht nevojat për shërbime sociale për viktimat e dhunës në familje, të moshuarit e vetmuar, PAK apo komunitetet, janë edhe nevojat më frekuente për të cilat shërbimet dhe personeli që i ofron ato janë të pamjaftueshëm. Koordinatori për barazinë gjinore dhe dhunën në familje mbulon njëkohësisht edhe NjMF. Ndërkohë që administratori shoqëror në NjA mbulon të dyja skemat e mbrojtjes sociale (ne para), atë të NE dhe PAK.

3.1.2 Zyra për barazinë gjinore dhe dhunën në familje

Zyra për barazinë gjinore dhe dhunën në familje (ZBGj) është ngritur në muajin Dhjetor 2012 me mbështetjen e UNDP. ZBGj punon për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi problemet gjinore me të cilat përballet komuniteti i bashkisë Përmet si dhe me menaxhimin dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Kjo zyrë kryen aktivitete të ndryshme ndërgjegjësimi në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile. Në kuadrin e funksioneve të saj Koordinatori organizon një herë në muaj mbledhjen e ekipit teknik multidisiplinar ku diskutohen rastet e raportuara të dhunës në familje dhe një herë në katër muaj mbledh Mekanizmin e Referimit për referimin e rasteve te identifikuara. Në funksion të zgjidhjes së rasteve emergjente të dhunës në familje ekziston një strehës e "përshtatur" pranë konvikteve, ku viktimat qëndrojnë deri në 72 orë, aq sa u nevojitet për marrjen e urdhrit të mbrojtjes nga gjykata.

Gjatë periudhës 2012-2013 PNUD-i u ka ofruar asistencë teknike tetë bashkive në bazë të Letër-Marrëveshjeve (i) për krijimin e RKK (Reagim i Koordinuar i Komunitetit) dhe ndërtimin e kapaciteteve për përfshirjen e perspektivës gjinore në planet e zhvillimit vendor.

Veçanërisht në bashkinë Përmet, ku nuk ka OJF të specializuara që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje, roli i specialisteve për çështjet BGj dhe DhF ka një rëndësi shumë të madhe. Shërbimet ndër-disiplinore, në veçanti ato të konsulencës ligjore dhe mbështetjes psiko-emocionale ofrohen brenda institucionit të bashkisë.

3.1.3 Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve

Identifikimi, verifikimi dhe monitorimi i rasteve të fëmijëve në nevojë realizohet përmes skuadrave të terrenit të cilat janë ngritur për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge si dhe rasteve të fëmijëve në nevojë brenda familjeve. Skuadrat veprojnë sipas një kalendari të miratuar nga koordinatori i zyrës, në të cilin janë parashikuar misione monitorimi në terren për të vlerësuar situatën e fëmijëve dhe për të hartuar planin individual të ndërhyrjeve me shërbime për ri-integrimin e këtyre fëmijëve në jetën normale. Gjithashtu, vizitat në familje janë një tjetër mënyrë për verifikimin e rasteve të individëve, familjeve apo grupeve me nevoja specifike për shërbime sociale, përfshirë këtu edhe fëmijët.

Gjatë Vitit 2018 janë identifikuar dhe menaxhuar 6 raste të fëmijëve në situatë rruge, të cilët shfrytëzoheshin nga familjarët e tyre për lypje. Shërbimet e përkujdesit për fëmijë ofrohen nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës e cila është funksionale prej Tetorit të 2018.

Në Ligjin e ri të arsimit parauniversitar[4], parashikohet krijimi i komisioneve shumë-disiplinore rajonale me mandatin e vlerësimit të kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuar; një komision i cili sugjeron nëse fëmija mund të integrohet në shkolla normale apo në "shkolla të veçanta". Në ZA-të Përmetit, komisioni multidisiplinar nuk është finalizuar ende, por është primare në realizimin e objektivave për një krijim dhe mbështetje sa më të shpejtë të fëmijëve me nevoja të veçanta. Edhe pse ligji e përmend qartë ngritjen dhe funksionimin e këtij komisioni shumë-disiplinor ende nuk është krijuar plotësisht ky komision dhe nuk ka një të dhënë të saktë se sa fëmijë dhe çfarë shërbimesh kanë përfituar nga struktura ekzistuese.

4 Ligji nr.69/2012 "Për Arsimin Parauniversitar" neni 5 " E drejta për Arsimim" dhe neni 6 "Parimet e përgjithshme për edukimin e fëmijëve

3.2 Burimet njerëzore dhe kapacitetet për të ofruar shërbime sociale

Sektori i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Përmetit në bashkëpunim me institucionet publike lokale dhe qendrore si dhe me organizata të shoqërisë civile ofron disa shërbime sociale për individët, familjet dhe grupet në nevojë. Megjithatë hendeku ndërmjet nevojave dhe mundësive për të ofruar shërbime është i madh si nga pikëpamja sasiore (mjaftueshmërisë) ashtu edhe nga pikëpamja cilësore (përshtatshmërisë).

Në njësitë administrative nuk funksionojnë *"grupet multidisiplinare për vlerësimin dhe referimin e rasteve".* Administratorët shoqërorë të NjA-ve janë të fokusuar tek verifikimi i ligjshmërisë së përfituesve të pagesave në para (ndihmë ekonomike dhe pagesë e aftësisë së kufizuar, etj.), duke lënë jashtë vëmendjes verifikimin e nevojave për shërbime që lidhen me rastet e dhunës në familje abuzimit dhe problematikave të fëmijëve.

Vlerësimi mbarëkombëtar i Situatës së Qeverisjes Vendore në Shqipëri, realizuar në kuadrin e Projektit STAR II, tregon se "Kënaqësia e qytetarëve ndaj shërbimeve" në Bashkinë Përmet është mbi mesataren e vendit. I njëjti vlerësim tregon se "lehtësia për të marrë shërbime" është vlerësuar "shumë e lehtë" (5) në shkallën e vlerësimit, duke e renditur Bashkinë Përmet një nga 4 bashkitë e Shqipërisë që kanë këtë vlerësim. Por një analizë më e thelluar, tregon se janë konstatuar disa shërbime si p.sh. strehimi social, shërbimet për PAK ose shërbimet sociale për fëmijët, të cilat janë shumë pak të disponueshme sidomos në zonat rurale.

Punonjësit e Bashkisë janë të mirë arsimuar dhe të motivuar për të ofruar shërbime cilësore në përputhje me nevojat e komunitetit. Megjithatë domosdoshmëria për të përmirësuar kapacitetet e burimeve njerëzore dhe aftësitë e tyre profesionale është imediate. Kjo për shkak të ndryshimeve sociale që kanë ndodhur në komunitet si dhe në përgjigje të dy reformave, asaj administrative e territoriale dhe reformës së shërbimeve sociale.

Vështirësitë kryesore kanë të bëjnë me gjetjen dhe mbajtjen e stafit të kualifikuar dhe sigurimin e trajnimeve ne vazhdimësi të stafit ekzistues. Përmirësimi i strukturave nga njëra anë dhe ai i kapaciteteve profesionale të stafit nga ana tjetër është një kërkesë imediate për Bashkinë Përmet.

3.3 Burimet financiare për ofrimin e shërbimeve sociale

Shpesh herë ndodh që shërbimet sociale, të mos jenë prioritet i politikave vendore dhe kjo shprehet edhe në planifikimin dhe përdorimin e burimeve financiare vendore për këto shërbime. Buxhetet e kufizuara që u vihen në dispozicion shërbimeve sociale përkthehen në numrin e kufizuar të këtyre shërbimeve të ofruara nga Bashkia. Megjithëse tre vitet e fundit buxheti i dedikuar për shërbime sociale ka një rritje vjetore prej 5%, konstatojmë se kjo rritje është e pamjaftueshme për të ofruar shërbime sipas nevojave[5].

Bashkia e Përmetit ka hartuar edhe PBA, megjithatë, bëhet fjalë për dy pasqyra financiare, që pasqyrojnë të ardhurat dhe shpenzimet, dhe jo për një buxhetim që i përgjigjet nevojave të Bashkisë për shërbime.

Ndërkohë Plani i Kujdesit Social është një mekanizëm i cili parashikohet të ofrojë një tablo të përgjithshme të planifikimit dhe menaxhimit të burimeve financiare vendore për shërbime të kujdesit social.

5 Shifra 5% është vlerësim i Sektorit ekonomik, pjesë e së cilës është zyra e shërbimeve sociale. Por në pasqyrat buxhetore të publikuara në web faqen e Bashkisë nuk ka asnjë evidencë që të tregojë se sa % e Fondit të pakushtëzuar dhe sa % e të ardhurave të bashkisë janë përdorur për shërbime sociale.

3.4 Shoqatat dhe shërbimet e përkujdesit social

Ajo çfarë vërehet në Bashkinë e Përmetit është se ka një mungesë të theksuar të organizatave jo-fitimprurëse të cilat duhet të veprojnë në Përmet[6]. Nevojat për këto organizata janë të mëdha, kjo nisur edhe nga problematikat që paraqesin grupet e margjinalizuara si p.sh. fëmijët, gratë, komunitetit rom, personat me aftësi të kufizuar, familje në varfëri ekstreme, mosha e tretë, invalidët e punës etj. Prania e këtyre organizatave do të bënte të mundur që disa prej këtyre problemeve që shqetësojnë këto grupe vulnerabël të merrnin zgjidhje. Bashkia po përpiqet që të vendosë kontaktet me organizata të shoqërisë civile të cilat janë të gatshme të japin kontributin e tyre në Përmet, pasi buxheti i pushtetit lokal është i pamjaftueshëm për të plotësuar të gjitha nevojat e grupeve në nevojë. Ajo çfarë vërehet është që organizatat që veprojnë në Bashkinë Përmet janë të pakta, të reja dhe jo me shumë eksperiencë.

Çfarë mund të identifikohet si një nga programet me aktive të shoqërisë civile në Përmet është programi i përbashkët i Bashkimit Europian dhe Këshillit të Europës "ROMACTED, i cili ka për qëllim "Promovimin e Qeverisjes së mirë dhe Fuqizimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane në nivelin vendor". Aktivitetet e programit fokusohen tek një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe integrimi i minoriteteve rome dhe egjiptiane përmes artit dhe kulturës.

3.5 Vlerësimi i situatës sociale për një vendimmarrje të informuar

Vendimmarrja e informuar përfaqëson një aspekt të rëndësishëm të mirëfunksionimit të qeverisjes vendore. Duke vlerësuar kapacitetet vendore për të mbledhur të dhëna dhe informacione për individët dhe grupet në nevojë kuptohet se ka një hendek të dhënash dhe nevojë imediate të bashkisë për të ndërtuar një data bazë me të dhëna të besueshme dhe të përditësuara. Në përgjithësi rezulton se vendimmarrja bazohet kryesisht në të dhëna empirike dhe të pa verifikuara me institucionet e tjera në nivel vendor. Një problem kryesor në këtë aspekt është mungesa e një punonjësi/zyre statistikore si dhe mungesa e një sistemi të integruar të dhënash. Për shembull, mungesa e statistikave në lidhje me numrin e fëmijëve me probleme sociale në territorin e bashkisë, ndikon drejtpërdrejt në një planifikim jo të mirë të shërbimeve ose përgatitjen e projekteve për këtë kategori sociale. Po kështu, nga grupet e interesit gjatë procesit të hartimit të Planit, u artikulua nevoja imediate për shërbime për moshën e tretë, por të dhënat për individët e moshuar të vetmuar apo me nevoja për shërbime shëndetësore në familje, mungojnë tërësisht.

3.6 Kufizimet, Mungesat dhe Çështje për adresim

- Personeli i pamjaftueshëm - mungesa punonjësve dhe operatoreve socialë, që shoqërohet edhe me burime të pamjaftueshme financiare dhe materiale;
- Struktura e vogël e Shërbimit Social në nivel zyre për ofrimin e shërbimeve sociale krijon vështirësi në ofrimin dhe menaxhimin e një sërë shërbimesh të kujdesit social;
- Megjithëse është miratuar statusi i punonjësit social, ka një paqartësi të mandatit dhe objektivave të punonjësit social në Bashki. Ata janë kryesisht administratorë dhe menaxherë dhe jo ofrues shërbimesh;
- Oferta e pamjaftueshme e shërbimeve sociale si rezultat i mungesës së operatorëve socialë, publikë dhe jo-publikë. Kjo pamjaftueshmëri shprehet në:

6 Gjate procesit te hartimit te PKS janë identifikuar 3 organizata jo-fitimprurëse aktive: "Solidariteti Tani", "FLOEM", " Arminda Ago"

a. një tipologji shumë të kufizuar të shërbimeve sociale. Shumë lloje të shërbime të parashikuara me VKM.518/2018 mungojnë totalisht në Bashkinë Përmet[7];

b. shërbime të cilat nuk mund të adresojnë nevojat e përdoruesve të tyre, mungon qasja multidisiplinare e ofrimit të shërbimeve (ndjekja dhe bashkëpunimi me shërbime të tjera brenda rrjetit lokal të shërbimeve);

c. mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktorëve kryesorë të administratës publike lokale dhe organizatave të tjera në ofrimin e shërbimeve sociale dhe adresimin e problemeve;

d. mjete të pamjaftueshme nga buxheti i Bashkisë të alokuara për shërbime sociale;

e. paqëndrueshmëri i financimit të shërbimeve sociale të prezantuara si shërbime pilot nga organizata të shoqërisë civile. Vështirësi për ti marrë përsipër këto shërbime nga institucionet vendore. Fragmentimi i burimeve dhe kufizimet të financimit;

f. "Mospërputhjet" e personelit të shërbimeve sociale me detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës - kompetencat e paqarta të vendeve të punës në shërbimet sociale.

- Përmirësimi i politikave lokale të kujdesit social për të gjitha kategoritë në rrrezik, e shprehur nëpërmjet shpërndarjes më të mirë e më efektive të burimeve financiare e njerëzore, me synim krijimin e fondit social në Bashkinë Përmet;
- Përmirësimi i angazhimit të qeverisjes vendore për të ofruar shërbime cilësore. Monitorimi i standardeve te shërbimeve në nivel lokal për kujdesin social;
- Sigurimi i aksesit të barabartë në shërbime cilësore për të gjithë kategoritë në rrezik duke përfshirë fëmijët, gratë, të rinjtë dhe të moshuarit pa lënë jashtë vëmendjes komunitetin egjiptian dhe ata që jetojnë në zonat e largëta;
- Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet shërbimeve të sistemit arsimor, shëndetësor, punësimit dhe atij social;
- Rritja e njohurive dhe aftësive të personelit nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm të gjithë personelit të përfshirë në ofrimin e shërbimeve (publik dhe jo publik);
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, nëpërmjet krijimit të mekanizmave për ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve, si dhe të udhëzuesve dhe protokolleve standarde për ndjekjen e situatës sociale të grupeve në nevojë;
- Ofrimi i "Shërbimeve parashoqërore" nëpërmjet edukimit për komunitetin, familjen dhe individin, sensibilizimin dhe mobilizimin e gjithë komunitetit, mas medias, shoqërisë civile etj., me mesazhin se "Bashkëjetesa sociale dhe solidariteti sigurojnë një sistem të mirëqenies më efektiv, më pjesëmarrës dhe më të qëndrueshëm";
- Fuqizimi ekonomik i grupeve te veçanta si gratë e të rinjtë nëpërmjet skemave te nxitjes së punësimit dhe formimit profesional;
- Përmirësimi i cilësisë së mbledhjes dhe përpunimit të informacionit dhe treguesve cilësor e sasior për individët, fëmijët dhe komunitetet në nevojë me qëllim krijimin e hartës së vulnerabilitetit.

7 Shiko Aneksi 4. "Shërbime të kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial në Bashkinë Përmet"

4. NEVOJAT PËR SHËRBIME SOCIALE TË GRUPEVE VULNERABËL DHE ATYRE NË RREZIK

4.1 Familjet e varfëra

Varfëria është një nga shkaqet kryesore të përjashtimit social. Sipas të dhënave të bashkisë Përmet, referuar Ligjit Nr.44//2016 "Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", numri i familjeve të varfëra në këtë bashki është 67 familje. Pjesa e popullsisë, që jeton më të ardhurat e skemës së ndihmës ekonomike kanë të ardhura mujore për frymë rreth 250 lekë/dite. Shifrat tregojnë se numri i familjeve të varfëra është ulur në bashkinë Përmet por kjo ulje mund të ketë ardhur si pasojë e aplikimit të sistemit të pikëzimit i cili ka penalizuar një numër të konsiderueshëm familjesh të cilat kanë qenë pjesë e skemës së NE-së. Familjet me më shumë se 5 anëtarë, kanë përqindjen më të lartë të varfërisë në Bashkinë Përmet.

Nisur nga burimet e të ardhurave të njësive ekonomike familjare (NJEF) të Bashkisë Përmet, të ardhurat nga punësimi dhe vetëpunësimi përfaqësojnë më shumë se gjysmën e të ardhurave familjare, rreth 55.7%, ndjekur nga ndihma ekonomike dhe transfertat që zënë 10.3% të të ardhurave familjare për popullatën lokale dhe më pas vijnë remitancat të cilat përfaqësojnë një përqindje shumë më të ulët, rreth 3.8% të të ardhurave familjare[8].

Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe shpërndarja e tyre sipas NJA identifikojnë qartë njësitë më të varfra në bashki. Kështu, përqindja e lartë e familjeve me ndihmë ekonomike (krahasuar me popullsinë) vihet re në Petran dhe Piskovë (50% e totalit të familjeve përfituese të bashkisë i përkasin këtyre dy NJA-ve).

Tabela 11 - Numri i familjeve përfituese te NE gjate tre viteve 2016, 2017, 2018[9]

Numri mesatar i familjeve përfituese të NE	2016	2017	2018
Përmet	177	104	22
Frashër	14	17	7
Çarshovë	10	9	3
Piskovë	62	61	24
Petran	26	27	11
Familje gjithsej (nr.)	289	218	67
Fondi vjetor (në mijë lekë)	**16,772**	**9,515**	**3,564**

Burimi i informacionit: Bashkia Përmet

8 https://instatgis.gov.al/#!/l/prefectures/population/prefpop1
9 Është llogaritur një mesatare e përfituesve të çdo muaji

4.2 Personat me aftësi të kufizuar

Deri në Dhjetor 2018, në Bashki janë evidentuar si përfitues të pagesës së paaftësisë 200 persona, nga të cilët 34 para dhe tetraplegjik dhe 83 me probleme të shikueshmërisë. Ajo çfarë artikulohet nga grupet e interesit[10] lidhur me PAK dhe shërbimet ndaj tyre është mungesa e shërbimeve të specializuara, mungesa e infrastrukturës (rampat që lehtësojnë lëvizjen e këtyre peronave) si dhe mungesa e personelit të specializuar për të ofruar shërbime sipas nevojave specifike të grupeve të PAK.

Tabela 12 - Numri i Personave me Aftësi të Kufizuar, para dhe tetraplegjik dhe të verbër sipas njësive administrative

Njësia Administrative	Persona të paaftë deri ne Dhjetor 2018			Persona para dhe tetraplegjik			Persona të verbër		
	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj	Femra	Totali
Përmet	54	36	90	14	8	22	27	25	52
Piskovë	26	25	51	0	2	2	13	3	16
Frashër	5	2	7	0	0	0	0	0	0
Petran	18	9	27	4	1	5	4	4	8
Çarshovë	11	14	25	2	3	5	6	1	7
Totali	**114**	**86**	**200**	**20**	**14**	**34**	**50**	**33**	**83**

Burimi i informacionit: Bashkia Përmet

4.3 Fëmijët në rrezik

Studimi "Reformimi i ndihmës ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë "[11] thekson se fëmijët e familjeve të varfëra dhe statusi i tyre social, mbeten problematike. Familjet në Ndihmë Ekonomike nuk mbulojnë nevojat e fëmijëve te tyre për ushqimin, shërbim shëndetësor si dhe nevoja të tjera të fëmijëve të garantuara nga ligji.

Në këtë situatë shteti mbetet faktori kryesor për kujdesin lidhur me fondet e vëna në dispozicion dhe në shërbime përkujdesi për familjet në nevojë dhe fëmijët e tyre. Duke iu referuar të dhënave administrative, aktualisht 114 fëmijë janë në përbërje të familjeve përfituese të NE, ose rreth 93% e familjeve të varfëra përfituese të ndihmës ekonomike kanë fëmijë (shih tabelën 13).

Tabela 13 - Numri i fëmijëve të familjeve në ndihme ekonomike

Numri i familjeve përfituese të NE me fëmijë nën 15 vjeç	2018				
	Totali	1 fëmijë	2 fëmijë	3 fëmijë	4 fëmijë
Përmet	15	8	7	0	0
Frashër	7	4	0	3	0
Çarshovë	3	2	0	1	0
Piskovë	26	7	11	7	1
Petran	11	4	6	0	1
Familje gjithsej (nr.)	62	25	24	11	2
Fëmijë gjithsej	114	25	48	33	8

Burimi i informacionit: Bashkia Përmet

10 Diskutimet me grupet e interesit gjatë procesit të hartimit të PKS
11 URI, NCSS studim i vitit 2013, mbështetur nga UNICEF

Legjislacioni i ndihmës ekonomike është përmirësuar vazhdimisht duke synuar gjithnjë e më shumë përfshirjen në skemë të individëve dhe familjeve në kushte më të vështira ekonomike dhe sociale.

Ligji i zgjeron kufijtë e përfitimit për të gjithë grupet në nevojë, krijon hapësirat e nevojshme për mbështetjen e fëmijëve të familjeve përfituese të NE-së. Në kuadrin e kësaj pakete bëhet e mundur që për herë të parë të krijohen hapësirat ligjore që pushteti vendor të marrë përgjegjësi për të kushtëzuar ndihmën ekonomike me mirërritjen e fëmijëve ku fëmija trajtohet si individ me një gjendje sociale të caktuar dhe jo si një anëtar i familjes.

4.3.1 Fëmijët me aftësi ndryshe

Sipas të dhënave të bashkisë, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar që shkojnë në shkollë ose në kopësht është 31 fëmijë. Por vetë administratorët pranojnë se numri i fëmijëve me AK në territorin e bashkisë është shumë më i madh. Këtë gjë e vërteton edhe një studim i bërë nga Observatori për të drejtat e fëmijëve: "Situata e fëmijëve me nevoja të veçanta" për vitin 2012 - Qarku Gjirokastër"[12], nga i cili është gjetur se numri i fëmijëve me nevoja të veçanta është 94 nga të cilët vetëm 58 fëmijë ose 61% janë të integruar në sistemin arsimor. Gjithashtu në Përmet janë diagnostikuar 30 fëmijë me spektrin e autizmit për të cilët mungojnë tërësisht shërbimet.

Tabela 14 - Numri i nxënësve me aftësi të kufizuar në kopshtet dhe shkollat sipas NJA-ve

NjA	Nxënës me aftësi të kufizuar në shkollat nëntë-vjeçare			Fëmijë me aftësi të kufizuar në kopshte		
	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj	Femra	Totali
Përmet	6	5	11	2	1	3
Piskovë	3	2	5	0	0	0
Frashër	0	0	0	0	0	0
Petran	6	3	9	0	0	0
Çarshovë	2	2	4	0	0	0
Totali	**17**	**12**	**29**	**2**	**1**	**3**

Burimi i informacionit: Bashkia Përmet

Me mbështetjen e Programit të Përbashkët të Kombeve te Bashkuara "Askush Të Mos Mbetet Pas" që financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe zbatohet nën mbikëqyrjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP, po ndërtohet një Qendër Komunitare Multifunksionale. Qendra pritet të përfundojnë brenda Marsit 2019 dhe do t'u ofrojë gjithë shërbimet e nevojshme fëmijëve me aftësi të kufizuara, si:

- Terapi zhvillimi (individuale dhe grupi) (bazuar mbi parimet e terapisë së sjelljes kur flitet për fëmijë me çrregullime të spektrit të autizmit);
- Terapi fizike (mosfunksioni motorik) (kryesisht individuale);
- Terapi okupacionale (të mësuarit/të ushtruarit e një pune, kryesisht grupi);
- Terapi të të folurit – (për vështirësi në komunikim, kryesisht individuale);
- Shërbime autonomie dhe higjienë personale;

12 http://observator.org.al/wp-content/uploads/2014/05/7_Gjirokastra_Situata_Femije_Nevoja_Vecanta_2012.pdf

- Aktivitete të socializimit dhe rekreative-kulturore;
- Një vakt i lehtë (i ofruar nga Bashkia);
- Transport (i përshtatur) i siguruar.

4.3.2 Fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët që punojnë

Shumica e fëmijëve në situatë rruge në Përmet janë të moshës 0-6 vjeç, të cilët janë në rrugë të shoqëruar nga nënat e tyre gjatë lypjes. Megjithatë punonjësit socialë të Bashkisë pranojnë se një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve që punojnë janë adoleshentë në situatë rruge të cilët janë të moshës 15-17 vjeç.

Bashkia Përmet dhe grupet e interesit, në takimet gjatë procesit të hartimit te PKS 2019-2023 kanë advokuar që të ketë aktivitete specifike për këtë grup në planin e veprimit. Gjithashtu ata janë shprehur që në kuadrin e "shërbimeve parashoqërore" të bëhen vlerësime për familjet e varfëra të cilat janë potencial për nxjerrjen e fëmijëve në rrugë ose shfrytëzimin e tyre për lypje.

Tabela 15 - Numri i rasteve të fëmijëve në situatë rruge të menaxhuara gjatë 2018

Bashkia Përmet		Tre mujori Tetor-Dhjetor 2018
Numri i rasteve të menaxhuara në total		6
Numri i rasteve të reja për vitin 2018		6
Sipas grup-moshës	*0-6 vjeç*	5
	7-14 vjeç	1
	15-18 vjeç	0
Sipas gjinisë	*Femra*	3
	Meshkuj	3
Sipas institucionit referues	*NJMF*	6
	Policia	0

Burimi: Bashkia Përmet NJMF

Përveç fëmijëve në situatë rruge, kemi edhe fëmijë, të cilët janë të detyruar të punojnë, për të ndihmuar familjet të dalin nga varfëria. Ndonëse të dhënat për fëmijët e punësuar në sektorin formal të ekonomisë mund të mblidhen nga të dhënat administrative të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, të dhënat për pjesën tjetër të fëmijëve, që punojnë mund të mblidhen vetëm nëpërmjet studimeve dhe anketimeve, te cilat për Bashkinë Përmet mungojnë plotësisht.

Kutia 1.

Sipas të dhënave nga Inspektorati për vitin 2014, në sektorin formal të ekonomisë (ne rang vendi) janë punësuar rreth 114 fëmijë. Shumica e fëmijëve të punësuar janë femra të moshës 17 vjeç. Shumica e fëmijëve kanë arsimin 9 vjeçar dhe janë punësuar në ndërmarrjet prodhuese.

4.4 Gratë me probleme sociale dhe dhuna në familje

Në Bashkinë Përmet janë regjistruar në total 35 raste për gratë e dhunuara për 6 vitet e fundit. Këto raste janë të pajisura të gjitha me urdhër mbrojtje.

Aktualisht Bashkia Përmet nuk disponon një strehëz mirëfilli për të strehuar rastet e dhunës në familje, por ka përshtatur një apartament ne godinën e konvikteve i cili ofron të gjitha kushtet e mira për një strehim cilësor.

Tabela 16 - Të dhëna për gratë e dhunuara ndër vite

Viti	Nr. Grave të dhunuara
Viti 2013	6 raste
Viti 2014	5 raste
Viti 2015	8 raste
Viti 2016	7 raste
Viti 2017	7 raste
Viti 2018	5 raste

Burimi i informacionit: Bashkia Përmet

4.5 Komunitetet

Treguesit socialë mes popullatës Egjiptiane në Bashkinë e Përmetit janë më të ulët se sa të pjesës tjetër të popullsisë. Shkaqet duhen kërkuar tek varfëria, kushtet e vështira të jetesës, mundësia e kufizuar për të përdorur shërbime cilësore të kujdesit social, niveli i ulët arsimor e mungesa e infrastrukturës. Një vlerësim i fundit i bërë nga ROMACTED me fokus familjet Egjiptiane në Bashkinë e Përmetit evidenton se 20 familje ose 30% e popullsisë Egjiptiane janë ekstremisht të varfër dhe përfitojnë nga programi i asistencës sociale (NE).

Kushtet e banimit janë të lidhura ngushtë me kushtet e jetesës. Në këtë kuptim familjet egjiptiane që jetojnë ne Bashkinë Përmet kanë probleme të lidhura me furnizimin me ujë të pijshëm, banjat dhe kanalizimet brenda banesave. Përveç kësaj, infrastruktura në përgjithësi duket se mungon, sepse një përqindje e madhe e anëtarëve të komunitetit pohojnë se jetojnë në lagje me rrugë të pa shtruara apo rrugë në gjendje të keqe.

Kutia 2.

Gjatë vitit 2015, rreth 290 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian përfituan direkt dhe indirekt nga implementimi i programit te MZHU-se "Për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve dhe egjiptianeve" në projektet e zbatuara në Bashkitë Rrogozhinë, Elbasan, Përmet, Vlorë, Berat, Lezhë, Lushnje, Sarandë dhe Rrëshen. Gjithashtu u përfshinë në punësim në fazën e zbatimit të tij duke ndikuar sado pak në cilësinë e jetës së tyre[13].

13 http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Plani%20i%20Veprimit%20ALB.PDF

Në dobi të rritjes së përfshirjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkollat e arsimit parauniversitar është krijuar databaza e të dhënave për regjistrimin e fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor, në kopësht dhe shkollë, nga viti 2010 e në vijim. Nga ky regjistrim rezulton se frekuentimi i shkollës nga fëmijët egjiptianë është maksimal njësoj si pjesa tjetër e komunitetit që jeton në këtë qytet. Arsimi i ulët dhe i mesëm është i frekuentuar në mënyrë të rregullt nga ky komunitet. Bashkia Përmet mbështetur nga aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë e vendorë kanë realizuar iniciativa të ndryshme me fokus familjet dhe fëmijët egjiptianë, si kampe verore, veprimtari kulturore, kualifikime specifike për mësues.

Me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, Përmetit (NJA Piskovë) i është akorduar një fond prej 6,033,952 lekë të reja për rehabilitimin e shtëpive të familjeve të komunitetit egjiptian.

4.6 Të rinjtë në rrezik

4.6.1 Të rinjtë në konflikt me ligjin

Shërbimi i Provës me mbështetjen e OSBE-së ka hartuar "Sistemin e vlerësimit për të miturit dhe të rinjtë në moshë madhore" me qëllim vlerësimin e rrezikshmërisë së tyre në shoqëri. Gjithashtu, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës është ngritur "Sektori i të Miturve, Shërbimeve Komunitare, Lirimit me Kusht dhe Statistikave", i cili inspekton punën e zyrave vendore me qëllim ruajtjen e standardeve të shërbimit të ofruar, rritjen e cilësisë së tyre si dhe zbatimin e kuadrit ligjor. Me ngritjen e Shërbimit të Provës aktualisht, numri i zyrave rajonale të shërbimit të provës është 22 në të gjithë vendin. Në Përmet, ekziston Zyra e Shërbimit të Provës e cila bashkëpunon me Bashkinë Përmet, për të krijuar hapësira dhe mundësi për të rinjtë në konflikt me ligjin, me qëllim ri-integrimin e tyre në shoqëri.

5. ANALIZA SWOT DHE PËRCAKTIMI I ÇËSHTJEVE KRITIKE DHE PRIORITETEVE

Përmeti është një nga zonat me potenciale zhvillimi ekonomik dhe social nga më të favorshmet në Shqipëri, për arsye të avantazheve ekonomike të qytetit dhe zonës së bashkisë në tërësi. Shfrytëzimi i këtij potenciali ekonomik në bazë të politikave vendore është i rëndësishëm për zhvillimin social, për të mundësuar që të jetë gjithëpërfshirës. Analiza e të dhënave administrative si dhe perceptimet mbi vulnerabilitetin të artikuluara nga grupet e interesit gjatë hartimit të PK-së, tregojnë se ka vend për politika sociale vendore të kujdesshme për të arritur pikërisht ato grupe që janë më në nevojë. Duke patur parasysh këtë gjë, nëpërmjet metodologjisë së ndjekur për hartimin e Planit të Përfshirjes Sociale 2019-2023, siguruam zërin e grupeve të interesit në përcaktimin e prioriteteve dhe masave për përfshirjen sociale të tyre.

Në kushtet e burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore të Bashkisë, analiza SWOT e realizuar me grupet e interesit na siguroi që të ndërtojmë një plan veprimi me konsensusin e të gjithë aktoreve. SWOT na mundësoi gjithashtu të marrim një pozicion të qartë rreth aftësive dhe mundësive që bashkia ka aktualisht si edhe rreth mundësive për të përmirësuar kapacitetet institucionale, materiale dhe njerëzore.

Tabela 17 - Analiza SWOT

PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA
• Një Bashki me potenciale ekonomike dhe kulturore të mëdha; • Popullsi relativisht të vogël që krijon mundësi për njohje shumë të mira mbi nevojat e territorit dhe grupeve në nevojë; • Popullsi homogjene me karakteristika shumë të mira të kohezionit social; • Potenciale ekonomike dhe burime natyrore avantazhuese krahasuar me qytete të tjera; • Një bashkëpunim shumë i mirë institucional midis nivelit qendror dhe lokal; • Staf i përkushtuar dhe dedikuar në ofrimin e shërbimeve; • Një numër i konsiderueshëm specialistësh të trajnuar për ofrimin e shërbimeve sociale duke adresuar grupe të veçanta.	• Niveli i lartë i papunësisë tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi ndryshe; • Shkalla e lartë e emigracionit jashtë vendit; • Mungesa e infrastrukturës arsimore për zhvillimi e aftësive profesionale; • Mbulesë e ulët me shërbime shëndetësore në të gjithë territorin e bashkisë; • Politikat sociale lokale deri diku të munguara të Bashkisë së Përmetit për përfshirjen sociale të grupeve të veçanta siç janë Romët, Egjiptianët dhe personat me aftësi ndryshe; • Mungesa e shërbimeve të integruara; • Burime të kufizuara financiare; • Terren i thyer malor në zonat rurale; • Grupet e interesit nuk janë të mirë-organizuar dhe kompakte në prezantimin e problemeve të tyre.

MUNDËSITË	RREZIQET
• Angazhim i pushtetit vendor në Bashkinë e Përmetit për respektimin e traditës dhe të drejtave të njeriut; • Bashkia Përmet dhe stafi është i angazhuar për të bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtarë; • Ekzistenca e organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe mekanizmave që i vlejnë procesit të përfshirjes sociale dhe angazhimin e grupeve të interesit në këtë proces; • Disa prej reformave të ndërmarra në vend adresojnë grupet e përjashtuara, (reforma kundër informalitetit, reforma e ndihmës ekonomike, reforma e pensioneve, reforma arsimore, etj.); • Reforma territoriale dhe Ligji i ri 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" zgjeron hapësirën e pushtetit vendor për përfshirjen sociale të grupeve të përjashtuara.	• Reforma territoriale dhe zgjerimi i hapësirës territoriale të funksionimit të pushtetit vendor të Bashkisë së Përmetit, ka bërë që shumë nga problemet sociale ekonomike të popullatës që kanë qenë jashtë territorit të Bashkisë, të mos njihen dhe për rrjedhojë të neglizhohen; • Një tërheqje e madhe e të rinjve drejt Tiranës; • Lëvizjet migratore brenda dhe jashtë vendit gjatë 20 viteve të fundit; • Legjislacioni në ndryshim të vazhdueshëm; • Ndryshimi i burimeve njerëzore (pothuajse çdo katër vjet).

5.1 Çështjet kritike

1. **Përmirësime në Strukturën e Shërbimit Social dhe burimet njerëzore**
   - Shërbimi i Përkujdesit Social të operojë si Sektor apo Drejtori më vete (aktualisht operon si zyrë).
   - Stafi i dedikuar për të trajtuar shërbimet qe lidhen me dhunën, moshën e tretë, PAK, komunitetet, etj.
   - Staf të specializuar për Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve që të bashkëpunojë me stafin ekzistues (Koordinatori për barazinë gjinore dhe dhunën në familje mbulon edhe NJMF).
   - Staf i specializuar dhe i dedikuar që të mbulojë PAK (Ndërkohë administratori social në NJA mbulon edhe shërbimet për aftësinë e kufizuar).
   - Ngritje e kapaciteteve të stafit për vlerësimin, menaxhimin dhe referimin e rasteve dhe ofrimin e shërbimeve të integruara dhe multifunksionale.

2. **Përmirësimi dhe Ngritja e Shërbimeve (të reja) të Kujdesit Shoqëror**
   - Ofrimi i Shërbimit në Familje për moshën e tretë: Ngritja e një Qendre Ditore dhe ofrimi Shërbimit në Familje sipas rasteve.
   - Ofrimi i Shërbimit në Familje për Fëmijët: Këshillim, ndihmë psikologjike, arsimim, etj. për t'i hequr nga situata rruge apo emergjente.
   - Ngritja e një qendre ditore që të ofroje shërbime me natyrë edukuese dhe kulturore për fëmijët dhe të rinjtë.
   - Ngritja e shërbimeve për të pastrehët.
   - Ngritja e Shërbimeve të strehimit të mbrojtur.
   - Ofrimi i shërbimit multifunksional për fuqizimin social dhe ekonomik te individëve, familjeve dhe grupe vulnerabël.
   - Rritja e bashkëpunimit me DAR dhe Shkolla për ndërgjegjësimin dhe informimin e fëmijëve dhe të rinjve.

6. PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE
(FUSHAVE, QËLLIMEVE DHE OBJEKTIVAVE TË PKS-SË)

FUSHA 1: KOORDINIMI DHE RRJETËZIMI I SHËRBIMEVE

Qëllimi 1. Rritja e bashkëveprimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve për të siguruar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve sipas nevojave në të gjithë territorin e Bashkisë Përmet.

Objektivi 1.1: Të ndërtojmë një sistem të qëndrueshëm dhe të standardizuar informacioni mbi nevojat për shërbime dhe ofruesit e shërbimeve.

Aktivitetet:

1. Krijimi i hartës së shërbimeve në territorin e Bashkisë Përmet dhe krijimi i shportës bazë të shërbimeve shoqërore;
2. Krijimi i hartës së vulnerabilitetit. Një vlerësim i shpejtë i nevojave për shërbime të kujdesit social për të gjitha grupet ne rrezik, në bashkëpunim me organizatat dhe operatorët që veprojnë në territor;
3. Krijimi i një baze të dhënash për individët/familjet dhe grupet, përfitues të shërbimeve dhe ndarja e të dhënave me operatorët/organizatat që ofrojnë shërbime në terren. Popullimi me të dhëna i Regjistrit Elektronik Kombëtar;
4. Vendosja e një linje telefonike në Bashki në përgjigje të rasteve emergjente.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, NJA, OJF-të, Donatorët, Ministria përkatëse.

FUSHA 2: STRUKTURAT DHE BURIMET NJERËZORE

Qëllimi 2. Fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe njerëzore të shërbimeve sociale.

Objektivi 2.1: Ngritja e mekanizmave dhe kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social sipas nevojave në të gjithë territorin e bashkisë Përmet.

Aktivitetet:

1. Ristrukturimi i zyrës në funksion të nevojave për shërbime sociale në territor;
2. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive për strukturën;
3. Ngritja dhe funksionalizimi i NJMF-ve;
4. Plotësimi i strukturës me staf mbështetës (1 jurist + 1 punonjës social - për NjMF);
5. Organizimi i takimeve periodike për forcimin e rrjetit të shërbimeve në nivel vendor;
6. Krijimi i strukturës së NVRR në Bashki dhe 4 njësi administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime;
7. Hartimi i një formati standard për menaxhimin e rasteve.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat.

Objektivi 2.2 : Të hartojmë mekanizmat për fuqizimin e strukturave te Bashkisë për vlerësimin e nevojave, financimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve që ofrohen nga operatorët që veprojnë në territorin e Bashkisë.

Aktivitetet:

1. Hartimi i planit të punës të funksionimit të NVRR;
2. Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të nevojave;
3. Hartimi i procedurave të kontrollit dhe monitorimit;
4. Krijimi dhe administrimi i Fondit Social;
5. Trajnimi i stafit (punonjësve të shërbimeve sociale) të Bashkisë mbi rrolin dhe përgjegjësitë që përcakton ligji nr.121/2016.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria përkatëse.

Objektivi 2.3: Të rriten kapacitetet e stafeve të strukturave të Shërbimit social në Bashki dhe Njësi Administrative.

Aktivitetet:

1. Trajnime për procedurën që do të ndiqet për funksionimin e NVRR;
2. Trajnime për rritjen profesionale, menaxhimin dhe planifikimin.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria përkatëse.

FUSHA 3: SHËRBIMET SOCIALE NË BASHKINË PËRMET

Qëllimi 3. Përmirësimi i shërbimeve sociale në territorin e Bashkisë së Përmetit.

Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Aktivitetet:

1. Ngritja e një qendre ditore në Bashki për shërbime sociale komunitare;
2. Hartimi i modelit të shërbimit;
3. Funksionimi i qendrës së shërbimeve komunitare;

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, ASHDMF, DRSHSSH, NJA.

Objektivi 3.2: Të ofrohen shërbime lehtësuese dhe mbështetëse për gratë kryefamiljare.

Aktivitetet:

1. Konsulencë ligjore falas për lehtësimin e procedurave për gratë kryefamiljare;
2. Nxitja e grave për përfshirje në programet e punësimit dhe sipërmarrje private.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, OJF, Biznesi.

Objektivi 3.3: Të ofrohen shërbime alternative për moshën e tretë (te moshuarit e vetmuar).

Aktivitetet:

1. Vlerësimi i nevojave për shërbime për "të moshuarit e vetmuar";
2. Ngritja e një shërbimi lëvizës për të moshuarit në banesë;
3. Vënia në funksionim e shërbimit;
4. Ngritja e një qendre ditore për të moshuarit dhe funksionalizimi i qendrës.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, DRSHSSH, NJA, OJF.

Objektivi 3.4: Të krijohen shërbime komunitare multifunksionale dhe të integruara për komunitetin Egjiptian.

Aktivitetet:

1. Ofrimi i programeve fuqizuese profesionale;
2. Ofrimi i programeve ndërmjetësuese dhe të integruara për punësimin e Komunitetit Egjiptian.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, DRFP, NJA, ZRP, OJF.

Objektivi 3.5: Ofrimi i shërbimeve për fuqizimin e të rinjve.

Aktivitetet:

1. Përfshirja e të rinjve në aktivitete vullnetare.
2. Ndërmjetësim për trajnime dhe kurse të formimit profesional për të rinjtë e papunë;
3. Shërbime ndërmjetësimi nëpërmjet zyrës së punës për punësimin e të rinjve të papunë;
4. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për parandalimin e përdorimit të drogës dhe alkoolit nga të rinjtë.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne Bashki, DRFP, NJA, ZRP, OJF, Zyra e punës.

Objektivi 3.6: Programe fuqizuese dhe shërbime për përmirësimin e cilësisë së jetesës së PAK nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Aktivitetet:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor për krijimin e lehtësirave ligjore për rritjen e aksesueshmërisë së kësaj kategorie në përfitimin e shërbimeve sociale (studim dhe rekomandime);
2. Trajnime për zbatimin e sistemi te ri të vlerësimit sipas "Modelit Social";
3. Hartimi i kritereve të reja për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar;
4. Vlerësimi i nevojave për shërbime për PAK;
5. Ngritja e një shërbimi lëvizës për PAK në banesë dhe vënia në funksionim e shërbimit;
6. Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi rëndësinë dhe mundësitë e programit të mbrojtjes shoqërore;
7. Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për instalimin e regjistrit elektronik për PAK;
8. Trajnime për përdorimin e regjistrit elektronik për PAK;
9. Mirëmbajtje e regjistrit elektronik për PAK;
10. Mirëfunksionimi i qendrës ditore për shërbimet për PAK.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, NJA, Ministria përkatëse.

FUSHA 4: PROGRAMET PARANDALUESE

Qëllimi 4: Planifikimi dhe ofrimi i programeve parandaluese.

Objektivi 4.1: Të rritet niveli i ndërgjegjësimit i grupeve të rrezikuara.

Aktivitetet:

1. Organizimi i aktivitete edukuese për të rinjtë në shkolla;
2. Program sensibilizues kundër diskriminimit dhe bullizmit;
3. Organizimi i programeve te këshillimit dhe mbështetëse për çiftet e reja.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, MSHMS, DAR, NJA, OJF.

Objektivi 4.2: Të ofrohen programe edukuese për fuqizimin e familjes në shërbimet ekzistuese

Aktivitetet:

1. Programe edukuese për fuqizimin e familjes;
2. Hartimi i programit dhe funksionalizimi.

Aktorët përgjegjës: Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, NJA, OJF.

Aneksi 1. Plani i Veprimit për Shërbimet e Kujdesit Social të Bashkisë Përmet

FUSHA 1: KOORDINIMI DHE RRJETËZIMI I SHËRBIMEVE							
Qëllimi 1. Rritja e bashkëveprimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve për të siguruar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve sipas nevojave në të gjithë territorin e Bashkisë Përmet.							
Aktivitetet	**Treguesit**	**Burimet e të dhënave**	**Aktoret përgjegjës**	**Koha**	**Financimi**		
					Kostot e parashikuar në lek	**Burimet e mundshme**	
						MFE; BASHKIA; NJA	**Donatorët e tjerë**
Objektivi 1.1:Të ndërtojmë një sistem të qëndrueshëm dhe të standardizuar informacioni mbi nevojat për shërbime dhe ofruesit e shërbimeve.							
1. Krijimi i hartës së shërbimeve në territorin e Bashkisë Përmet dhe krijimi i shportës bazë të shërbimeve shoqërore	Studim për finalizimin e hartës së shërbimeve	DSHS &NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, NJA, OJF-të, Donatorët, Ministria përkatëse	2019	200,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Krijimi i hartës së vulnerabilitetit. Një vlerësim i shpejtë i nevojave për shërbime të kujdesit social për te gjitha grupet ne rrezik, në bashkëpunim me organizatat dhe operatorët që veprojnë në territor	Studim			2019	200,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3. Krijimi i një baze të dhënash për individët/familjet dhe grupet, përfitues të shërbimeve dhe ndarja e të dhënave me operatorët/organizatat që ofrojnë shërbime në terren. Popullimi me të dhëna i Regjistrit Elektronik Kombëtar	Databazë e përfunduar dhe e mirëmbajtur me të dhëna të azhornuara			2019	1,500,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
4. Vendosja e një linje telefonike në Bashki në përgjigje të rasteve emergjente	Linjë telefonike e dedikuar ne Bashki			2019-2020	90,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
TOTALI					**1,990,000**		

FUSHA 2: STRUKTURAT DHE BURIMET NJEREZORE							
Qëllimi 2. Fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe njerëzore të shërbimeve sociale.							
Aktivitetet	**Treguesit**	**Burimet e të dhënave**	**Aktoret përgjegjës**	**Koha**	**Financimi**		
					Kostot e parashikuar në lek	**Burimet e mundshme**	
						MFE; BASHKIA; NJA	**Donatorët e tjerë**
Objektivi 2.1:Ngritja e mekanizmave dhe kapaciteteve per ofrimin e sherbimeve te kujdesit social sipas nevojave ne te gjithe territorin e bashkise Permet.							
1. Ristrukturimi i zyrës në funksion të nevojave për shërbime sociale në territor	Zyra funksionale bashkëkohore	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat	2019 - 2020	10,000,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësive për strukturën	Përshkrime pune të finalizuara			2019	n/a	n/a	n/a
3. Ngritja dhe funksionalizimi i NJMF-ve	NJMF funksionale ligjërisht/ institucionalisht			2019	n/a	n/a	n/a
4. Plotësimi i strukturës me staf mbështetës (1 jurist + 1 punonjës social -për NjMF)	Staf i rekrutuar			2019-2023	43,200,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
5. Organizimi i takimeve periodike për forcimin e rrjetit të shërbimeve në nivel vendor	15 takime			2019-2023	75,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

6. Krijimi i strukturës së NVRR në Bashki dhe 4 njësi administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbim	NVRR funksionale ligjërisht/ institucionalisht			2019	n/a	n/a	n/a
7. Hartimi i një formati standard për menaxhimin e rasteve	Udhëzues për monitorimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve			2019-2020	200,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
Objektivi 2.2: Të hartojmë mekanizmat për fuqizimin e strukturave te Bashkisë për vlerësimin e nevojave, financimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve që ofrohen nga operatorët që veprojnë në territorin e Bashkisë.							
1. Hartimi i planit të punës dhe manual bazë procedurash për funksionimin e NjVRR	Plan pune dhe manual bazë procedurash i përfunduar në Dhjetor 2019	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria	2019	300,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Hartimi i metodologjisë së vlerësimit të nevojave	Metodika për vlerësimin e nevojave			2020	200,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3. Hartimi i procedurave te kontrollit dhe monitorimit	Manual i përfunduar			2020	200,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
4. Krijimi dhe administrimi i Fondit Social	Fondi social 1% e të ardhurave të bashkisë			2020-2023	20,000,000	Bashkia / MFE	n/a
5. Trajnimi i stafit (punonjësve të shërbimeve sociale) të Bashkisë mbi rolin dhe përgjegjësitë që përcakton ligji nr.121/2016	5 trajnime dy-ditore me pjesëmarrje nga të gjitha NVRR			2019-2023	500,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

Objektivi 2.3: Të rriten kapacitetet e stafeve të strukturave të Shërbimit social në Bashki dhe Njësi Administrative.							
1. Trajnime për procedurën që do të ndiqet për funksionimin e NjVRR	1 trajnim me pjesëmarrje nga të gjitha NjVRR	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Njësitë Administrative, OJF/shoqatat, Ministria	2019	70,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Trajnime për rritjen profesionale, menaxhimin dhe planifikimin.	5 trajnime një-ditore me pjesëmarrje nga të gjitha NVRR			2019-2023	350,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
TOTALI					**74,975,000**		

FUSHA 3: SHËRBIMET SOCIALE NË BASHKINË PËRMET							
Qëllimi 3. Shërbimeve sociale te përmirësuara dhe te shtrira në të gjithë territorin e Bashkisë Permet.							
Aktivitetet	**Treguesit**	**Burimet e të dhënave**	**Aktoret përgjegjës**	**Koha**	**Financimi**		
					Kostot e parashikuar në lek	**Burimet e mundshme**	
						MFE; BASHKIA; NJA	**Donatorët e tjerë**
Objektivi 3.1: Të përmirësohet situata e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.							
1. Ndërtimi i qendrave ditore me një seksion të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve në Bashki dhe 4 Njësi Administrative për shërbime sociale komunitare	5 qendra funksionale në 2021	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, ASHDMF, DRSHSSH, NJA	2019-2020	97,500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

1. Ndërtimi i qendrave ditore me një seksion të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve në Bashki dhe 4 Njësi Administrative për shërbime sociale komunitare	5 qendra funksionale në 2021	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, ASHDMF, DRSHSSH, NJA	2019-2020	97,500,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Hartimi i modelit të shërbimit	Manual shërbimi për mbrojtjen e fëmijëve			2020	300,000		
3. Funksionimi i qendrës se shërbimeve komunitare	5 qendra funksionale në 2021			2020-2023	15,700,000		
3.1. Menaxhimi i rasteve sociale në rrezik (fëmijë) në bashkëpunim me aktorët lokale	100 raste të mbuluara				1,000,000		
3.2. Identifikim dhe rekrutim i familjeve kujdestare dhe trajnimi i tyre	20 familje				100,000		
3.3. Sensibilizim për çështje që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve, grave të moshuarve, etnitë, PAK	60 aktivitete			2020-2023	1,200,000		
3.4. Aktivitetet - kampe verore për fëmijët ne nevoje dhe jo vetëm	40 aktivitete				4,000,000		
3.5 Veprimtari ditore të qendrës komunitare	Qendër funksionale				5,400,000		

Objektivi 3.2: Të ofrohen shërbime lehtësuese dhe mbështetëse për gratë kryefamiljare.							
1. Konsulencë ligjore falas për lehtësimin e procedurave për gratë kryefamiljare	Konsulencë ligjore falas për 270 raste në Bashki e NJV ne 5 vitet	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, OJF, Biznesi	2019-2023	10,800,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit te vene ne dispozicion nga donatoret e tjere
2. Nxitja e grave për përfshirje në programet e punësimit dhe sipërmarrje private	40 projekte propozime të shkruara së bashku me gratë e interesuara			2019-2023	4,000,000		
Objektivi 3.3: Të ofrohen shërbime alternative për moshën e tretë(te moshuarit e vetmuar).							
1. Vlerësimi i nevojave për shërbime për "të moshuarit e vetmuar"	Studim / vlerësim nevojash	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale ne bashki, DRSHSSH, NJA, OJF	2019	n/a	n/a	n/a
2. Ngritja e një shërbimi lëvizës për te moshuarit në banesë	Shërbim lëvizës funksional			2019-2023	n/a	n/a	n/a
3. Vënia në funksionim e shërbimit për moshën e tretë	Shërbim i ofruar për 270 raste në Bashki e NJV në 4 vitet			2019-2023	2,700,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
4. Ngritja e një qendre ditore për të moshuarit dhe funksionalizimi i qendrës	1 qendër funksionale në 2021			2019-2023	31,500,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
4.1. Ndërtimi dhe vënia në funksionim e një Qendre ditore për të moshuarit në Bashki				2019-2021	19,500,000		
4.2. Vënia në funksionim e shërbimit për moshën e tretë, fillimi i veprimtarisë së seksionit të të moshuarve në qendër				2022-2023	12,000,000		

Objektivi 3.4: Të krijohen shërbime komunitare e multifunksionale dhe të integruara për komunitetin Egjiptian.							
1. Ofrimi i programeve fuqizuese të formimit profesional	implementim i programeve të ndryshme për 100 të rinj të komunitetit	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, DRFP, NJA, ZRP, OJF	2020-2023	6,000,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Ofrimi i programeve të integruara ndërmjetësuese për punësimin e Komunitetit Egjiptian	100 të punësuar nga komuniteti deri në 2022			2020-2021	n/a	n/a	n/a
Objektivi 3.5: Ofrimi i shërbimeve për fuqizimin e të rinjve.							
1. Përfshirja e të rinjve në aktivitete vullnetare	Aktivitete vullnetarizmi organizuar nga klubet rinore	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, DRFP, NJA, ZRP, OJF, Zyra e punës	2019-2023	4,050,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Ndërmjetësim për trajnime dhe kurse të formimit profesional për të rinjtë e papunë	100 të rinj përfundojnë kurse profesionale			2019-2023	6,000,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
3. Shërbime ndërmjetësimi nëpërmjet zyrës së punës për punësimin e të rinjve te papunë	marrëveshje bashkëpunimi mes Bashkisë/NJA me zyrën e punës			2019-2023	n/a	n/a	n/a
4. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për parandalimin e përdorimit të drogës dhe alkoolit nga të rinjtë	një fushate ndërgjegjësuese e realizuar çdo vit në çdo shkollë të ciklit të ulët dhe të mesme			2019-2023	2,500,000	për tu përcaktuar, sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë

Objektivi 3.6: Programe fuqizuese dhe shërbime për përmirësimin e cilësisë së jetesës së PAK nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në lekë me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.							
1. Përmirësimi i kuadrit ligjor për krijimin e lehtësirave ligjore për rritjen e aksesueshmërisë së kësaj kategorie në përfitimin e shërbimeve sociale (studim dhe rekomandime)	2 studime	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, NJA, Ministria	2019-2023	400,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Trajnime për zbatimin e sistemi të ri të vlerësimit sipas "Modelit Social"	1 trajnim			2019-2023	50,000		
3. Hartimi i kritereve të reja për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar	1 studim			2019-2023	300,000		
4. Vlerësimi i nevojave për shërbime për PAK	Studim			2019-2023	200,000		
5. Ngritja e një shërbimi lëvizës për PAK në banesë dhe vënia në funksionim e shërbimit	Strukture funksionale për shërbimin lëvizës			2019-2023	13,500,000		
6. Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi rëndësinë dhe mundësitë e programit të mbrojtjes shoqërore	5 fushata			2019-2023	500,000		
7. Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për instalimin e regjistrit elektronik për PAK	1 regjistër			2019-2023	1,000,000		
8. Trajnime për përdorimin e regjistrit elektronik për PAK	1 trainim			2019-2023	50,000		
9. Mirëmbajtje e regjistrit elektronik për PAK	54 muaj			2019-2023	540,000		

10. Funksionimi normal i qendrës ditore që ofron shërbime për PAK	54 muaj (korrik 2019 - dhjetor 2021) shërbime për rreth 755 PAK	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në Bashki, NJA, Ministria	2019-2023	70,704,054	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
10.1. Shërbime para shoqërore (informim e këshillim shërbim në familje)					4,860,000		
10.2. Shërbime komunitare parësore (pritje e vlerësim nevojash)					8,109,000		
10.3. Shërbime komunitare dytësore dhe të tjera aktivitete ne familje					17,910,000		
10.4. Administrimi i qendrës dhe Burimet Njerëzore (pagat)					39,825,054		
TOTALI					**268,294,054**		

FUSHA 4: PROGRAMET PARANDALUESE							
Qëllimi 4. Planifikimi dhe ofrimi i programeve parandaluese.							
Aktivitetet	**Treguesit**	**Burimet e të dhënave**	**Aktoret përgjegjës**	**Koha**	**Financimi**		
					Kostot e parashikuar ne leke	**Burimet e mundshme**	
						MFE; BASHKIA; NJA	**Donatorët e tjere**
Objektivi 4.1: Të rritet niveli i ndërgjegjësimit i grupeve të rrezikuara.							
1. Organizimi i aktivitete edukuese për të rinjtë në shkolla	10 fushata dhe 20 aktivitete	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, MSHMS, DAR, NJA, OJF	2019-2023	1,100,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Program sensibilizues kundër diskriminimit	10 fushata dhe 20 aktivitete			2019-2023	1,100,000		
3. Programe këshillimi dhe mbështetëse për çiftet e reja	50 takime ndërgjegjësuese për çiftet e reja në 5 NJV			2019-2023	500,000		
Objektivi 4.2: Të ofrohen programe edukuese për fuqizimin e familjes në shërbimet ekzistuese.							
1. Programe edukuese për fuqizimin e familjes	Manual	DSSH & NJA	Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale n bashki, NJA, OJF	2020	200,000	për tu përcaktuar sipas buxhetit në dispozicion nga Bashkia	sipas fondit të vënë në dispozicion nga donatorët e tjerë
2. Hartimi dhe vënia në funksion e programit	50 takime ndërgjegjësuese për çiftet e reja në 5 NJV			2020-2023	500,000		
TOTALI					**3,400,000**		

Aneksi 2. Plani i monitorimit dhe vlerësimit

Plani i Kujdesit Social i Bashkisë Përmet është dokumenti që tregon rrugën e zbatimit të politikave të shërbimeve sociale në nivel lokal. Plani adreson nevojat prioritare të individëve, familjeve dhe grupeve në territorin e bashkisë, në përputhje të plotë me rolin dhe përgjegjësitë e drejtpërdrejta të përcaktuara në Ligjin 121/2016 "Për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Plani i monitorimit dhe vlerësimit është pjesë integrale e PKS-së dhe do të shërbejë për të matur shkallën e realizimit të qëllimeve dhe objektivave të tij si dhe për të monitoruar aktivitetet e parashikuara. Raporti i progresit të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve të vendimmarrësve, partnerëve dhe grupeve të interesit.

Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit e Planit Social është Drejtoria e Shërbimeve Sociale që mbledh të dhënat mbi treguesit për të identifikuar progresin e objektivave dhe qëllimeve të PKS-së. Gjithashtu DShS do të ketë rol koordinues dhe bashkërendues në procesin e zbatimit të Planit dhe do të ketë përgjegjësinë e përgatitjes së progres raporteve vjetore. Plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave, hartimit të instrumenteve të standardizuara të raportimit si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me strukturat e nivelit rajonal, qendror dhe OJF-të. Të dhënat administrative do të përdoren nga pjesa më e madhe e institucioneve vendore për të monitoruar përfitimin e grupeve në nevojë nga programet e shërbimeve parashoqërore, programet e shërbimeve në komunitet dhe programet e shërbimeve rezidenciale afatgjata dhe shërbimeve t**ë** specializuara.

Një vëmendje e veçantë në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Planit të Kujdesit Social do t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të bashkisë dhe institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për të garantuar mbledhjen e të dhënave të grupeve të targetuara.

Cikli i monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijë tre faza:

1. Vlerësimin e situatës sociale të grupeve në nevojë, në fillim të periudhës së PKS (2019);
2. Vlerësimi i ndërmjetëm (mund të jetë vjetor) i treguesve duke ndjekur kalendarin e aktiviteteve dhe rishikimi i tyre, në rastet kur objektivat nuk ndjekin progresin e parashikuar;
3. Vlerësimi përfundimtar i PKS i cili do të bëhet në fund të 2023 dhe do të përcaktojë progresin e objektivave realizimin ose mosrealizimin e qëllimeve si dhe impaktin social të Planit.

Mënyra e raportimit dhe konsultimit

Instrumenti kryesor në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të Planit Social do të jetë Raporti Vjetor i Shërbimeve Sociale, i përgatitur nga Sektori i Shërbimeve Sociale në Bashkinë e Përmetit. Baza e raportit do të jenë të dhënat statistikore mbi grupet në nevojë dhe ato përfituese të cilat do të sigurohen edhe përmes konsultimeve me grupet e interesit. Raportet e vlerësimit do të bëhen të njohura edhe për publikun. Raporti do të hartohet dhe miratohet brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës të vitit të monitoruar.

Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit

Treguesit përfundimtarë *(treguesit matës të synimeve)*

1. Procedurat dhe dokumentet e krijuara në kuadrin e këtij Plani;
2. Strukturat e krijuara;
3. Krijimi i bazës së të dhënave;

4. Numri i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumë palëshe të nënshkruara ndërmjet aktoreve;
5. Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të planit të veprimit;
6. Përqindja e popullsisë së vetëdijësuar për çështjet e të drejtave të grupeve të prekura;
7. Numri i projekteve dhe programeve që fuqizojnë grupet në risk;
8. Numri i viktimave të DHBGJ të identifikuara (sa nga këto janë fëmijë);
9. Numri i rasteve të dhunës të parandaluara (sa nga këto janë fëmijë);
10. Numri i individëve/familjeve që i është ofruar një shërbim adekuat (strehim, punësimi, arsimimi, mbrojtje ligjore, kompensim, etj.);
11. Numri i rasteve te identifikuara, ndjekura dhe referuara;
12. Numri/përqindja e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike të mbështetura, me programe të fuqizimit ekonomik të cilët kanë dalë nga skemat.

Treguesit e ndërmjetëm

Shiko treguesit e monitorimit të aktiviteteve në Planin e Veprimit.

Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit

1. Faqja e internetit e Bashkisë Përmet;
2. Raportime ne mbledhjet e Këshillit Bashkiak;
3. Sistemi i standardizuar i mbledhjes dhe përpunimit të informacionit;
4. Të dhënat administrative/statistikore të DShS;
5. Publikime;
6. Anketime dhe vrojtime të popullatës mbi nivelin e kënaqshmërisë për shërbimet e marra nga Bashkia (në kuadrin e "Transparencës" dhe "Pjesëmarrjes së qytetarë ve në vendimmarrje dhe buxhetim");
7. Vrojtime të bëra në nivel lokal dhe kombëtar.

Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur progresin në arritjen e objektivave dhe përmbushjen e qëllimeve. Pasi të hartohen raportet e progresit, bazuar mbi të dhënat dhe vrojtimet, ato do të shpërndahen ndërmjet përdorueseve të cilët do të jenë:

1. Publiku (komuniteti i Bashkisë Përmet);
2. Këshilli Bashkiak;
3. Kryetari i Bashkisë Përmet;
4. Institucionet shtetërore qendrore dhe lokale;
5. Shoqëria civile;
6. Partnerët ndërkombëtarë;
7. Media.

Përgjegjësi kryesor për shpërndarjen e rezultateve do të jetë Bashkia (DSHS dhe Sektori për

Marrëdhëniet me Publikun). Publikimi i rezultateve do të bëhet edhe nëpërmjet faqes së internetit të Bashkisë Përmet, medias ose duke organizuar seminare dhe tryeza, për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e PKS duke angazhuar në mënyrë të veçantë komunitetin dhe grupet e interesit.

Modeli për monitorimin e rezultateve

Përparimi i bërë në zbatimin e PKS duhet të monitorohet rregullisht nga autoriteti përgjegjës, Bashkia Përmet (DSHS). Në këtë kuptim të dhënat që ndërlidhen me aktivitetet e zbatimit të parapara në PKS duhet të grumbullohen dhe analizohen. Modeli i propozuar më poshtë për monitorim duhet të adaptohet për aktivitetet specifike.

Institucioni Implementues i aktivitetit	
Partnerët	
Personi kontaktues	
Fusha (specifiko një nga fushat)	**Korniza mbështetëse** P.sh. - Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve të kujdesit social
Aktiviteti	
Rezultatet e planifikuara	
Rezultatet e arritura	
Buxheti	
Donatori ose Institucioni mbështetës	
Evidenca	
Koha e realizuar	

Roli i shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar në zbatimin e Planit të Veprimit

Plani i Veprimit identifikon organet shtetërore që janë përgjegjëse për zbatimin e secilit prej aktiviteteve, por një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve luajnë edhe grupet e tjera të interesit, të cilat lidhin institucionet me grupet në nevojë, si dhe financojnë ndërhyrjet e synuara për përmirësimin e situatës dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. OJF-të që punojnë për përmirësimin e jetës së grupeve në nevojë dhe ofrojnë shërbime direkte për ta janë identifikuar veçanërisht si partnerë kyç për realizimin e objektivave të Planit Social.

Gjatë periudhës në vijim, bashkia do të vazhdojë të mbështetet në ndihmën për ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale, plotësimin e nevojave për strehim të sigurt, punësim dhe bashkëpunimin në fusha të tjera. Komuniteti ndërkombëtar do të kontribuojë gjithashtu në zbatimin e Planit Social duke promovuar shembujt e praktikës së mirë nga Shqipëria dhe Rajoni, si dhe duke bashkë financuar disa prej aktiviteteve. Për të lehtësuar këtë proces, bashkia ka identifikuar aktivitete specifike të Planit Social që do të përmirësonin situatën e grupeve dhe komuniteteve në nevojë në territorin e Bashkisë Përmet.

Aneksi 3. Kostimi dhe Hendeku Buxhetor

Shënime të përgjithshme

Plani i Kujdesit Social për Bashkinë Përmet fokusohet në 4 fusha kryesore:

1) Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve;
2) Strukturat dhe burimet njerëzore;
3) Shërbimet sociale në bashki;
4) Programet parandaluese.

Plani i Kujdesit Social për Bashkinë Përmet është dizenjuar mbi bazën e 4 qëllimeve kryesore që do të arrihen nëpërmjet realizimit të 11 objektivave që do të bëhen të mundura nëpërmjet implementimit të rreth 46 aktiviteteve specifike, të cilat do të kontribuojnë në arritjen e synimeve prioritare. Plani i Veprimit do të zbatohet në periudhën 2019-2023.

Buxhetimi është hartuar mbi bazë programi, i cili përmban të gjithë kostot e lidhura me një fushë të politikës (p.sh. Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve). Buxhetimi mbi bazë programi nënkupton fillimisht përcaktimin e politikave e me tej mbi këtë qasje politike përcaktohen qëllimet /objektivat / produktet /aktivitetet.

Objektivat e Politikës janë arritje specifike të politikës, saktësisht të matshme në kohë, numër dhe kosto, që mund të arrihen gjatë periudhës dhe që janë hapa të ndërmjetme drejt arritjes së Qëllimit të Politikës. Të gjitha shpenzimet e programit duhet të kontribuojnë në përmbushjen e Objektivave të deklaruar. Objektivat duhet të jenë të pavarura nga njëra-tjetra në mënyrë që të maten veçmas pa krijuar mbivendosje apo vlerësim të dyfishtë.

Kostimi i aktiviteteve është realizuar bazuar në metodologjitë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, më konkretisht duke konsideruar *shpenzimet e projekteve* të *trupëzuara* në *produkte (investimet)* dhe ato *jashtë projekteve* (*paga, sigurime dhe shpenzimet operative*). Një metodologji e tillë është në përputhje me sistemin e planifikimit buxhetor afatmesëm në RSH sikurse parashihet në ligjin organik të buxhetit dhe në udhëzimet përkatëse MF.

Shembull kostimi:

Objektivi 1

↘

Produkti B

↘

Aktiviteti B 1

Pema e Programit është një mënyrë skematike për të përshkruar punën e planifikuar të një Programit. Pema tregon se si burimet e shpërndara në detyra individuale (Aktivitete) eventualisht do të çojnë në realizimin e ambicieve afatgjata të politikës (Qëllimeve). Shuma totale e burimeve të shpërndara në Aktivitete do të barazojë shpenzimet totale të buxhetuara të Programit. Ose, e parë nga një këndvështrim tjetër, do të tregojë se si ambiciet afatgjata të politikës (Qëllimi) konvertohen në një set konkret detyrash (Aktivitete) të cilat do të kryhen vit pas viti që do të rezultojnë në Produkte dhe të cilat mund të maten dhe monitorohen me qëllim që të sigurojnë që politika e synuar është zbatuar.

PEMA E PROGRAMIT



Qëllimi i kostimit është përcaktimi i shpenzimeve të detajuara për të gjitha aktivitetet e planit të veprimit bazuar në analizën dhe informacionin e marrë nga institucionet përgjegjëse, kryesisht Bashkisë Përmet.

Objektivat specifik të procesit të kostimit janë:

i. kostimi realist i të gjitha aktiviteteve;

ii. analiza e detajuar e burimeve buxhetore të brendshme institucionale, dhe

iii. analiza e detajuar e burimeve të jashtme në dispozicion.

Rezultatet kryesore dhe konkluzionet nga procesi i kostimit

Procesi i kostimit kërkoi një angazhim dhe kohë të dedikuar. Për çdo objektiv/rezultat/aktivitet u bë një analizë e detajuar për të përcaktuar qartë njësinë, sasinë, koston/njësi dhe koston totale për çdo aktivitet.

Një plan i mire buxhetor mundëson:

- *Një deklaratë gjithëpërfshirëse të Bashkisë që të shndërrojë politikat e veta për Shërbimin Social në veprime konkrete nëpërmjet buxhetimit të shërbimeve.*
- *Një plan të detajuar pune për këdo që punon në departamentin e Shërbimeve Sociale në Bashki që arritjet të mund të krahasohen me planin.*

Konkluzione nga procesi i kostimit

- Kostot e përgjithshme vjetore për zbatimin e PKS kanë një shtrirje pak a shumë uniforme për periudhën 2019-2023.
- Nga llogaritjet rezulton që buxheti i Bashkisë me burimet nga të ardhurat totale në dispozicion për 5 vite mund të mbulojë kostot e përgjithshme për zbatimin e planit të veprimit 2019-2023 (pa

konsideruar në këtë buxhetim koston e pagave të personelit aktual, shpenzime rutinë të personelit të shërbimeve sociale si dhe kostot pëNE, por vetëm ndërhyrjet përmirësuese të parashikuara në këtë plan aktivitetesh). Gjithësesi nga ky kostim shikohet që Bashkia do të duhej të shpenzonte 33% të buxhetit total dhe të heqë dorë nga shpenzime të tjera që i përgjigjen politikave të bashkisë dhe që mund të jenë njësoj apo edhe më tepër prioritare për të. Në një situatë realiste, bashkia nuk do të mbulonte 100% këto kosto ndaj ndërhyrja me fondet e donatorëve të ndryshëm është e domosdoshme;

- Shpenzimet më të mëdha nevojiten për arritjen e objektivave të fushës 2 (11% e kostove të përgjithshme) dhe fusha 3 (88% e kostove të përgjithshme). Fusha 3 ka të përfshirë kosto për ndërhyrjet përmirësuese për PAK si dhe pagesat mujore për këto kategori, ndaj edhe ka një kosto kaq të lartë.

Rekomandime për Buxhetimin e PKS Bashkisë Përmet

Konkluzionet e mësipërme nxjerrin nevojën e marrjes së masave që do të çonin në gjetjen e burimeve alternative të financimit, për aktivitetet që nuk mund të mbulohen nga buxheti i Bashkisë.

- Procesi i kostimit dhe konkluzionet e mësipërme mund të përdoren nga Bashkia dhe institucione të tjera përgjegjëse për zbatimin e PKS si një dokument për të negociuar me donatorë potencial.
- Fondet e angazhuara nga donatorët për zbatimin e PKS janë të panjohura saktësisht. Stafi i Bashkisë duhet të angazhohet në shkrim projektesh dhe thithje fondesh nga donatorë të ndryshëm për mbulimin e 100% të shpenzimeve të parashikuara në këtë plan buxhetor.
- Dokumenti mund të përdoret nga Bashkia Përmet si një mjet për të argumentuar kërkesat e tyre për fonde gjatë miratimit të projekt buxhetit vjetor në Këshillin Bashkiak, për periudhën 2019-2023.
- Në Bashkinë Përmet duhet të rriten kapacitetet e stafit për të hartuar projekt propozime në funksion të zbatimit te PKS, në mënyrë që të mundësojnë ngritjen e fondeve.
- Duhet të koordinohet në vazhdimësi marrja e informacionit nga agjenci të ndryshme donatore dhe aktorë lokal në mënyrë që të rritet efektiviteti dhe efikasiteti i përdorimit të fondeve që janë në dispozicion dhe të shmangen mbivendosjet e panevojshme.

Aneksi 4. Shporta e shërbimeve shoqërore

A - Shërbime parashoqërore:		
	Informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi on-line	
B - Shërbime në komunitet:		
Shërbimi në Familje	Nuk ka	i. shërbime rehabilitimi, zhvillimi, këshillim psikologjik e ligjor sipas rastit; ii. shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi; iii. dhënien e medikamenteve sipas recetës së mjekut apo shërbime të tjera të kujdesit të shëndetit; iv. mbajtjen e higjienës personale; v. përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti.

Shërbimi i përkujdesjes alternative	Nuk ka	i. fëmijë pa kujdes prindëror; ii. fëmijë të privuar në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga mjedisi familjar.
Shërbimi multi-funksional	i. Shërbime për rehabilitimin fizik dhe psiko-social; ii. Këshillime për punësimin, edukimin shëndetësor, arsimim, argëtim.	i. këshillime ligjore falas, këshillim për prindërimin; ii. fuqizimin e individit/ familjes.
Qendrat ditore	i. Personat me aftësi të kufizuara - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë terapi zhvillimi, fizioterapi, logopedi, ortofoni, terapi okupacionale, mbështetje psikologjike, përkujdesje fizike, ushqim për qëndrimin ditor.	i. fëmijë që jetojnë në situatë rruge dhe fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike – Shërbimet për këtë kategori përfshijnë shërbime për higjienë personale, ushqim, mbështetje për edukim, mbështetje, psikologjike dhe sociale, aktivitete të kohës së lirë që nxisin edukimin dhe integrimin; ii. të moshuarit - Shërbimet për këtë kategori përfshijnë mbështetje psikologjike, kujdes shëndetësor, aktivitete të kohës së lirë, përfshirje në komunitet dhe ushqim.
Shërbimi i emergjencës 72 orë	i. 48 orë viktima të dhunës në familje dhe fëmijët.	i. fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara; ii. të moshuarit apo individë të braktisur në situatë rruge.
Shërbimi për të pastrehët	Nuk ka	i. strehim gjatë natës; ii. mensë; iii. mbështetje me këshillim dhe referim për fuqizim dhe ri integrim sa më të shpejtë.
Shërbimi i strehimit të mbrojtur		i. mbështetje për jetesë brenda dhe jashtë ambientit të banimit, terapi rehabilituese, këshillim dhe mbështetje për integrim në tregun e punës për personat me aftësi të kufizuara; ii. strehim, siguri fizike, ushqim, kujdes shëndetësor, trajtim psikologjik dhe emocional, këshillim dhe referim të shërbimet rehabilituese dhe ri integruese në tregun e punës për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit, në përputhje me vlerësimin e kryer për nevojat e tyre.
C - Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.		
Shërbimet afatgjata rezidenciale	Vetëm në nivel kombëtar	i. shërbime rezidenciale për të moshuarit, nënat – vajza, gratë e dhunuara, gratë e trafikuara, të alkoolizuar dhe përdorues droge, personat me aftësi të kufizuar. Këto shërbime ofrojnë qëndrim, akomodim, ushqim, arsim, kulturim, shërbime shëndetësor, këshillim ligjor, psikologjik dhe social.